

**MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E PUNËVE TË BRENDSHME
ME OBJEKT “MBI AUDITIMIN E LIGJSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË
FINANCIARE”, PËR PERIUDHËN 30.09.2013 - 31.12.2014.**

Raporti Përfundimtar i Auditimit i ushtruar në Ministrinë e Punëve të Brendshme, me objekt “Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare” për periudhën 30.09.2013 deri 31.12.2014, si dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH-së Nr. 72, datë 08.06.2015. Bazuar në nenet 15, 25, 30 dhe 32 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, me shkresën nr. 1074/10, datë 08.06.2015, Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet përkatëse i janë dërguar z. Saimir Tahiri, Ministër i Punëve të Brendshme, ku janë rekomanduar dhe kërkuar zbatimi i masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE.

1. Nga auditimi i PBA dhe projekt buxheteve të viteve 2013 dhe 2014 rezultoi se, nga Ekipet e Menaxhimit të Programeve në Ministrinë e Brendshme, për disa produkte është bërë një ***përcaktim formal i emërimit dhe llogaritjes së tyre***. Këto produkte janë programuar me emërtime abstrakte dhe jo në mënyrë të qartë e të detajuar, çka bën të vështirë ndarjen e shpenzimeve në programim, por sidomos ndarjen dhe përcaktimin nëpër produkte të shpenzimeve faktike për çdo produkt dhe llogaritjen e kostos së tyre.

Ky fenomen është më i prekshëm tek programi “Policia e Shtetit”, ku produkte si “Forca Speciale dhe e ndërhyrjes së Shpejtë në Gatishmëri, ndërhyrje për vendosjen e rendit të cenuar” në vlerën e planifikuar dhe të realizuar, ka të përfshirë edhe vlerën për blerjen e automjeteve me LC, të cilat nuk kanë qenë të programuara në fillim të vitit. Gjithashtu, në produktet e programeve të tjera si “Shërbime të patrullave të përgjithshme”, kosto për njësi si në plan edhe në fakt është shumë e vështirë të përcaktohet saktë; produkti “Raporte financiare për menaxhimin e lartë” dhe “Planifikim, menaxhim administrim”, në të cilët vlera e produktit në fakt është rritur me 12 herë, etj.

Për këtë është rekomanduar:

Ekipet e Menaxhimit të Programeve të MPB, në hartimin e programimit buxhetor afatmesëm të përcaktojnë qartë produktet e programit, në mënyrë të tillë që secili produkt të ketë të saktësuar drejt njësinë matëse dhe koston për realizimin e tij, duke mbajtur në konsideratë në përcaktimin e produkteve dhe objektivat që do të realizojë çdo program. Të synohet në përgatitjen e manualeve të koston sipas produkteve në mënyrë që të forcohet menaxhimi financiar dhe kontrolli si element i rëndësishëm i rritjes së përgjegjshmërisë në administrimin e fondeve.

Vazhdimisht

2. Nga analiza krahasimore e treguesve të dy viteve buxhetore 2013-2014, në të gjitha fazat e programimit të shpenzimeve buxhetore, por dhe gjatë vitit buxhetor, u konstatuan se shpenzimet për investime ndryshojnë nga faza e programimit deri në realizimin e tij, me rreth 2.8 herë, çka tregon se kërkesat dhe programimi i PBA nga grupet e menaxhimit të programeve, nuk i nënshtrohet një analizë të hollësishme e të argumentuar, për domosdoshmërinë e investimeve që në fazat e para të programimit deri në fazën e aprovimit, apo ndryshimet e këtij plani gjatë vitit.

Për këtë është rekomanduar:

Drejtoria e Financës, në bashkëpunim me Grupet e Menaxhimit të Programeve dhe me strukturat që mbulojnë planifikimin dhe monitorimin e investimeve në Ministrinë e Financave, të qartësojnë dhe rakordojnë planifikimin vjetor të shpenzimeve të domosdoshme për investime, me programimin e PBA, për arritjen e objektivave, në mënyrë që të largohemi nga praktika e formalitetit në realizimin e funksioneve që lidhen me buxhetimin.

Vazhdimisht

3. Nga auditimi i realizimit të buxhetit për periudhën e auditimit u konstatua se gjatë vitit 2014 është përdorur Letër Kredi për likuidimin e kontraktorëve të ndryshëm për blerjet e realizuara si për investimet dhe për shpenzimet operative, për njësi të varësisë së Ministrisë së Punëve të Brendshme. Konstatuam se përdorimi i LC (letër kredi, apo fondit të ngurtësuar në një bankë të nivelit të dytë deri në realizimin e kontratës) në këtë institucion, është bërë në Programin “Policia e Shtetit” për “Blerje automjete për QFMT”, në vlerë 372,340,000 lekë, dhe në Gardën e Republikës për “Blerje Pistoleta 9x9 FS-92 Bereta” me ofertë ekonomike në vlerë 6,995,000 lekë. Në Programin “Policia e Shtetit” rezultoi se është bërë pagesa ndaj Operatorit ekonomik “H A” shpk për “Blerjen e 40 Mikrobuseve dhe 4 fuoristrada” në vlerë 169,176,000 lekë. Kontrata me nr. 5763/3, datë 18.12.2014, është firmosur nga Drejtori i Policisë së Shtetit z. A.D. dhe në nenin 4 të saj, pika 1, përcaktohet se afati i lëvrimit të mallit është 90 ditë nga lidhja e kontratës. As në kontratë, po as në një aneks të saj, nuk janë përcaktuar kushtet e përdorimit të LC, Formulari i Letër Kredisë mban datën 24.12.2014, firmosur nga Nëpunësi Autorizues i QFMT. Të njëjtën situatë e konstatuam edhe për pagesën ndaj operatorit ekonomik “C” shpk për “Blerjen e 15 Mikrobuseve me kalueshmëri të lartë (4x4) dhe 2 ambulancave”, në vlerë **114,600,000 lekë**. Kontrata mban datën 18.12.2014, dhe është firmosur nga Drejtori i Policisë së Shtetit z. A.D., afati i lëvrimit të mallit është 90 ditë nga lidhja e kontratës.

Letër Kredi është përdorur për shërbimin “Suport teknik të licencave Memex për vitin 2014”, në vlerë 73,743 USD, një shërbim i kontraktuar për më shumë se 10 vjet nga firma ruse “P Z”. Kontrata për këtë shërbim me nr. 44/4, datë 03.06.2014, është e firmosur nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit z. A.D. Formulari i letër kredisë më datë 27.11.2014, në nenin 71/b, ka të përcaktuar se vlera e komisioneve bankare, do të likuidohen nga pala shqiptare (në anglisht), firmosur nga Drejtori i Përgjithshëm A.D..

Me urdhër shpenzimi nr. 599, datë 12.12.2014, në vlerë **8,355,082 lekë**, është likuiduar kontrata e këtij shërbimi për vitin 2014. Gjithashtu me këtë urdhër shpenzimi është bërë likuidimi i komisioneve të letër kredisë, në vlerë 51,569 lekë.

Në lidhje me përdorimin e Letër Kreditit në Gardën e Republikës për vitin 2014, na rezultoi se ky mjet pagese është përdorur vetëm në një rast, për blerjen e armatimit me vlerë **6,995,000 lekë**. Nga Garda e Republikës me shkresën nr. 2920/1, datë 17.12.2014, është kërkuar çelja e letër kredisë për “Arms School Academy” shpk, në vlerën 6,995,000 lekë dhe afatin e lëvrimit të shumës deri datë 31.03.2015. Në formatin me emërtim “Normat për kredinë dokumentare”, në pikën 12 është përcaktuar se (AK) *pranon që tani rezultatet kontabël të bankës duke dhënë dorëheqjen nga çdo përjashtim.*

Konstatojmë se këtë vit (2014) është realizuar me këtë formë likuidimi 30% të fondeve të për investime në programin e Policisë së Shtetit. Për të gjitha përdorimet e Letër Kredisë, nuk kishte një marrëveshje të qartë midis palëve (bankës ku ishin çelur Letër Kreditit/LC dhe institucionit që ngurtëson fondet për likuidimin e kontratave), për kushtet dhe vlerat e komisioneve që detyrohen të paguajnë palët për këto “ngurtësime të fondeve buxhetore”. Vetëm për vitin 2014, është bërë likuidimi i komisioneve të letër kredisë në vlerë **51,569**

lekë. Nisur nga sa kemi konstatuar si dhe faktit që është cënuar rëndë parimi kryesor i realizimit të buxhetit ai i annualitetit, rekomandojmë:

- Të eliminohen praktika të tilla në realizimin e shpenzimeve buxhetore, sidomos në fund të vitit. Në raste të veçanta (të përcaktuara qartësisht me akte normative), të ketë formate ku specifikohen qartë kushtet e përdorimit të LC, në veçanti për masën e komisioneve dhe mënyrën e pagesës së tyre, pasi të sigurohet dakordësia me Ministrinë e Financave. Rekomandojmë me forcë që në këtë proces të përcaktimit të marrëveshjeve dhe kushteve të tyre, të sigurohet që strukturat drejtuese të MPB, të bashkëpunojnë me Ministrinë e Financave dhe domosdoshmërisht me Bankën e Shqipërisë.

- Të nxirret përgjegjësia institucionale për raportimin e buxhetit në kundërshtim me rregullat dhe parimet bazë buxhetore, lidhur me deklarimin e investimeve/shpenzimeve të pa kryera si të realizuara.

Menjëherë

4. Në funksion të auditimit të nivelit të detyrimeve të cilësuar si borxh dhe të përfshira në strategjinë e shlyerjes së detyrimeve të prapambetura, u audituan zërat Debi-Kredive të Aparatit të MPB dhe rezultoi se nga strukturat menaxhuese, është punuar për shlyerjen e detyrimeve ndaj furnitorëve, por nuk është punuar me asnjë strukturë, në asnjë drejtim për arkëtimin e detyrimeve debitorë trashëguar në vite. Shuma që i detyrohen subjektet Aparatit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, pa mundur të arkëtohen në buxhetin e shtetit për vite me radhë, është në vlerë **32,528,754 lekë.**

Për këtë është rekomanduar:

Strukturat menaxhuese të Aparatit të Ministrisë së Punëve të Brendshme në bashkëpunim me Ministrinë e Financave të marrin masa për të siguruar arkëtimin e debitorëve të trashëguar me vite pra vlerën 32,528,754 lekë., ndërsa për debitorët pa shpresë arkëtimi të veprohet për shuarjen e tyre në kontabilitet.

Menjëherë

5. Strukturat menaxhuese të MPB dhe njërive shpenzuese të saj, nuk kanë punuar për arkëtimin e debitorëve të trashëguar me vite ndaj saj, të cilët në fund të vitit 2013 rezultojnë:

- Në llogarinë “Personeli, paradhënie, deficite e gjoba” vlera prej 451,994,847 lekë gjithsej, nga e cila shuma 209,988,221 lekë pa shpresë arkëtimi;

- Në llogarinë “Debitorë të ndryshëm” vlera prej 2,408,025,604 lekë gjithsej, nga e cila shuma 1,348,229,900 lekë pa shpresë arkëtimi.

Për këtë është rekomanduar:

Strukturat menaxhuese të Ministrisë së Punëve të Brendshme, pasi të miratojnë në Ministrinë e Financave vlerën për “Debitorët pa shpresë arkëtimi”, të verifikojnë dhe evidentojnë realisht debitorët e trashëguar në vite, për të bërë të mundur arkëtimin e detyrimit në favor të buxhetit të shtetit.

Në vazhdimësi

6. Vlera e Aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara (AQT) kryesisht ndërtesa dhe rikonstruksione, në kontabilitet, është shumë e ulët ndaj vlerës së tregut, pasi nuk është bërë rivlerësimi i tyre. Vlera kontabël e kësaj llogarie nuk përputhet me vlerën e amortizimit dhe vlerën e mbetur për çdo objekt në fund të vitit është 2014.

Është bërë inventarizimi i pronave dhe është i miratuar me vendimet përkatëse nga Këshilli i Ministrave, por nuk është përfunduar regjistrimi i tyre në ZVRP.

Për këtë është rekomanduar:

a. Njësitë menaxhuese dhe përmbledhëse të njësive shpenzuese të DPPSH, të hartojnë listën përmbledhëse të AQT për vitin 2014, me vlerën fillestare të tyre, amortizimin e llogaritur, shtesat nga rikonstrukcionet dhe vlerën e mbetur për çdo objekt, e cila duhet të jetë e barabartë me vlerën e bilancit përmbledhës të saj për vitin 2014.

b. Njësitë shpenzuese të këtij institucioni, gjatë programimit të buxheteve vjetore duhet të parashikojnë një fond të caktuar për vlerësimin dhe regjistrimin e pronave në përdorim.

Menjëherë

7. Për periudhën e audituar struktura, organika, pozicionet, kategoritë dhe numrat për çdo pozicion kanë funksionuar sipas 3 Urdhrave të Kryeministrit nr. 190, datë 18/10/2013, nr. 81, datë 21/02/2014 dhe nr. 226, datë 15/09/2014. Numri i punonjësve në organikë është respektuar, por konstatoam se nga institucioni paguhen edhe 38 nëpunës civil që janë në listë pritje për një periudhë 1 vjeçare, me një efekt financiar në buxhetin e shtetit që shkon rreth **38,1 milion lekë**. Konstatoam se:

- janë kryer pagesa të raporteve mjekësore brenda periudhës 14 ditore, për të cilat nuk është llogaritur, ndaluar dhe derdhur sigurimi shoqëror në vlerën 326,913 lekë si dhe tatim mbi të ardhurat nga paga në masën prej 142,278 lekë.

- nuk është plotësuar rregullisht regjistri i punonjësve me azhurnimin e të gjitha lëvizjeve sipas dokumentacionit që vërteton këto lëvizje si dhe pagat e tyre.

- ka raste që për punonjësit e rinj (të emëruar rishtazi) në shkresat, që nënshkruhen nga ministri, si titullar i institucionit, lihet bosh data e fillimit të punës dhe marrëdhënieve financiare. Emërtimi në strukturën organike të nëpunësve civilë të kategorisë së ulët drejtuese, që kanë qenë përgjegjës sektorësh, nuk ka mbështetje me ligjin e ri nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, Kreu III “Klasifikimi i pozicioneve në shërbimin civil”, neni 19 “Klasifikimi”, pika 6, germa (a), pasi nuk ka më emërtim “Përgjegjës Sektori”, por janë me emërtimin “Shef Sektori”.

- për 2 punonjës të ministrisë, jepej shtesë me cilësimin në listë pagesë “shtesë kualifikimi”, ndërkohë që pagesa kishte të bënte me shpërblim për pjesëmarrje në komisione apo programe. Në urdhrin për këtë lloj pagese, nuk gjendej e përcaktuar numri i pagesave që duhej të bëhej.

Për këtë është rekomanduar:

a. Nga institucioni të merren masat e nevojshme për përcaktimin e numrit të shpërblimeve për periudhën 1 vjeçare, në vazhdim të urdhrin përkatës të ministrit ku përcaktohet shpërblimi në masën 20,000 lekë, i zv/ministrit për pjesëmarrje në mbledhje si Kryetar i Komisionit të Vlerësimit të Programit Mbrojtjes së Dëshmitarëve e Bashkëpunëtoreve të Drejtësisë të Ministrisë së Punëve të Brendshme, në përputhje me VKM nr. 418, datë 27.6.2012.

Menjëherë

b. Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marrë masat e nevojshme, që çdo ndryshim i mbiemrit të punonjësve në listë pagese, në rastet e ndryshimit të mbiemrit në gjendjen civile, të bëhet zyrtarisht midis Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, si dhe të vërtetimit për bankat, për numrin e llogarisë të çelur për efekt marrje page. Drejtoria e Buxhetit dhe e Financës të marrë masat e nevojshme, që në kryerjet e pagesave të raporteve mjekësore deri në 14 ditë, të kryej ndalesat për efekt të sigurimeve shoqërore e shëndetësorë, si dhe tatimin në burim.

c. Të plotësohet regjistri i punonjësve me të gjitha të dhënat dhe të mbahet ai i përditësuar me të gjitha ndryshimet në pagë. Të bëhen rregullimet në emërtimin e vendit të punës të punonjësve të rinj, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”

Vazhdimisht

8. Nga auditimi i procedurave të zbatimit të vendimeve gjyqësore konstatoam se shumica e pagesave nuk është kryer vullnetarisht, por me ndërmjetësinë e Zyrave Përmbartimore, për të cilat janë paguar edhe vlera të konsiderueshme tarifash përmbartimore, çka përbën një shpenzim joefektiv të fondeve të buxhetit të shtetit. Nga auditimi i praktikave dokumentare rezultoi se për shumë vendime gjyqësore (të cilat nuk i referohen shpërblimit të dëmit), kur janë ekzekutuar nuk është kryer ndalesa e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, ndërsa tatimi në burim i janë ndaluar çdo punonjësi. Nga auditimi rezultoi se skemës së sigurimeve i mungon një vlerë prej **5,132,135 lekë**, për vendimet e ekzekutuara.

Në dy raste të audituar u konstatuan pagesa në zbatim të vendimeve gjyqësore (paga deri në momentin e kthimit në punë), megjithëse personi figuron të jetë i punësuar në një institucion tjetër shtetëror. Nisur nga ky fakt, është llogaritur që ish punonjësja e MPB zj. T.Sh. duhet të kthejë një vlerë të përfituar padrejtësisht në shumën 1,177,551 lekë, nga dy punësimi në shtet për periudhën 22/9/2009 deri 31/12/2011, gjithsej 27 muaj.

Shumat e paguara bëhen më të larta, për shkak se vendimet gjyqësore shprehen se punonjësve të larguar duhet tu paguhet paga deri në kthimin e tyre në punë, ndërkohë që Institucioni nuk ka zbatuar ekzekutimin vullnetar të vendimeve, duke e shoqëruar atë edhe me shpenzimet e përmbartimit, të cilat përbëjnë kosto shtesë për buxhetin e shtetit.

Për këtë është rekomanduar:

a. Nga institucioni të merren masat e nevojshme që për të gjithë vendimet gjyqësore (ku kërkohet që të paguhet paga) të fituara nga punonjësit e larguar nga puna, të kryhen ndalesat e sigurimeve shoqërore e shëndetësore si dhe tatimi në burim, duke planifikuar si shpenzim buxhetor edhe pjesën e sigurimeve që duhet të derdhë institucioni.

Rast pas rasti.

b. Nga ana e Institucionit, gjatë ndjekjes së çështjeve gjyqësore me punonjësit e larguar, ose/dhe para se të kryejë pagesën në zbatim të vendimeve gjyqësore, të kërkojë nga punonjësit përfitues, të kërkojnë deklaram personal në të cilin të jenë shprehur nëse kanë punuar në ndonjë subjekt tjetër për periudhën kohore si dhe të vendosin një komunikim zyrtar me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, për të kërkuar verifikimin e këtyre deklarimeve, me qëllim shmangien e pagesës në dy vende pune për të njëjtën periudhë kohore. Kur konstatohen, vërtetohen raste të punësimit në një institucion tjetër, ndërkohë që përfitojnë pagesë dhe nga zbatimi i vendimit gjyqësor, pra ka përfitim të dyfishtë për të njëjtën periudhë, për pagesë, Institucioni të bëjë rilogaritjet, korigjimet përkatëse. Në rast mos dakordësie me personin përfitues, para se të kryhet pagesa, Institucioni të ndjekë çështjen në rrugë gjyqësore.

Rast pas rasti.

c. Detyrimet financiare për pagat e punonjësve të larguar padrejtësisht nga puna sipas vendimeve të formës së prerë të gjykatës, të regjistrohen në kontabilitetin përkatës të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe institucioneve vartëse. Të merren masat e nevojshme për zbatimin vullnetar të detyrimeve të krijuara pas vendimeve të formës së prerë të gjykatës,

me qëllim eliminimin e pagesës së tarifës së shërbimit të përmbaresit, e cila përbën shpenzim joefektiv për buxhetin e shtetit.

Rast pas rasti.

d. Sektori i Financës të mos përcaktoj vlerat për pagesë, për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, që kanë lidhje me largimet e punonjësve nga puna, por të verifikojë dhe plotësojë urdhër shpenzimet përkatëse për ekzekutimet e tyre, pasi llogaritja e tyre është detyrim i Drejtorisë Juridike dhe Përafrimit të Legjislacionit, në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Rast pas rasti.

9. Nga auditimi i procedurave të prokurimit kemi konstatuar se njësia e prokurimit në kriteret e veçanta të kualifikimit (KVK) kryesisht për blerje, ka kërkuar që *operatori ekonomik duhet të deklarojë cilësinë dhe origjinën e mallit që ofron të cilat janë objekt prokurimi....* Në thelb një kriter i tillë është kërkesë për “Autorizim prodhuesi”. Formulimi i kriterit për cilësinë dhe origjinën e mallrave si më sipër nga njësia e prokurimit, ka lënë vend për interpretime të gabuara nga KVO në kualifikimin/skualifikimin e OE dhe komprometimin në tërësi të procedurës së zhvillimit të tenderëve. Gjithashtu, njësia e prokurimit ka përfshirë në kriteret e veçanta të kualifikimit (KVK), kryesisht në tenderët për blerje “Veshmbathje”, specifikimet teknike, si... *raport analizë të kryer nga laboratorë të akredituar në Republikën e Shqipërisë,* në kundërshtim me pikën 3 të Kap. III të VKM nr. 1, datë 10.01.2014 i ndryshuar. Vendosja e kësaj kërkesë specifike në KVK, ka orientuar me detyrim, që OE t’i marrin analizat vetëm te një laborator, duke e vendosur këtë të fundit në pozicion të privilegjuar, monopol ndaj të ngjashmëve dhe si tregon praktika, vendimtar në përcaktimin e OE fitues,

Për këtë është rekomanduar:

Njësia e prokurimit të OQB, në hartimin KVK, të jetë e drejtpërdrejtë, e qartë e kuptueshme, të mos lerë vend për interpretime, me qëllim që t’i sigurojë AK realisht dhe besueshmërisht, se shpenzimet që po ata po kryejnë, janë të garantuara për cilësinë dhe origjinën e mallrave të blerë.

Në vazhdimësi

Njësia e prokurimit të mos përfshijë specifikimet teknike në KVK. Gjatë hartimit të specifikimeve teknike për mallra, të mos kufizojë kryerjen e analizave vetëm nga Laboratorë të akredituar në Shqipëri (ka vetëm një), por në zbatim të dispozitave ligjore ekzistuese, të kërkojë dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare të lëshuara nga *institucione të autorizuar (licencuar)*, pa kufizim.

Në vazhdimësi

10. Në tërësi, nga auditimi i procedurave të prokurimit të fondeve publike, *u konstatuan mangësi të njëjta*, të cilat dëshmojnë për mungesën e harmonizimit të punës midis Njesisë së Prokurimit Publik dhe KVO-ve, qëndrime teknike dhe interpretime të ndryshme të ndryshme për të njëjtat çështje etj, të cilat kanë ndikuar në copëzimin e fondeve publike, mungesën e nxitjes së konkurrencës, pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë, sigurimit të një trajtimi të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë konkurrentët pjesëmarrës etj. Mbështetur në këto konstatime, me qëllim përdorimin me efikasitet të plotë të fondeve publike **rekomandojmë:**

a. Drejtoria e Përqendruar e Prokurimeve Publike në MPB, të marrë masat e nevojshme për eliminimin e parregullsive procedurale të konstatuara gjatë zhvillimit të prokurimeve publike,

të përshkruara gjerësisht projektraportin e auditimit, “Mbi prokurimet me fonde publike”, të cilat konsistojnë në kërkesën e dokumentacioneve nga autoritetet kontraktore, për argumentimin e fondeve limite.

b. Në argumentimin me hollësi të çdo kërkesë kualifikuese të veçanta nga njësitë e prokurimit, vendosjen e tyre pa interpretime, si dhe duke kërkuar shoqërimin me dokumente vërtetuese që qarkullojnë nga institucione apo subjekte të njohura në Shqipëri, e sidomos të kërkesave për të paraqitur certifikata të ndryshme “ISO”.

c. Të kërkojë kufizimin maksimal për të paraqitur si dokumente vërtetuese në KVK, deklarata personale të operatorëve ekonomikë.

d. Plotësimin e gjurmëve të auditimit në çdo dosje tenderi, duke përcaktuar juristin e njësisë së prokurimit ashtu edhe specialitetet e fushës për anëtarët e KVO-ve, si dhe mbylljen e “arkivimit” në platformën elektronike dhe kryerjet e inventarizimeve të dosjeve përkatëse menjëherë mbas përfundimit të procedurave të çdo tenderi etj.

Vazhdimisht

e. Drejtoria e Përqendruar e Prokurimeve Publike e MPB, në cilësinë e OQB, të marrë masat e nevojshme në bashkëpunim me AK, që blerje dhe shërbime të veçanta të përdorimit të përditshëm e të rëndësishëm për zhvillimin e aktivitetit normal të punës, si katering i spitaleve të ndryshme, forcave të armatosura të reparteve ushtarake, blerjet e karburanteve etj. të kësaj natyre, të zhvillohen brenda afateve kohore të përcaktuara nga autoritetet kontraktore, me qëllim eliminimin e procedurave të ndërmjetme prej tyre, deri në përfundimin e tenderit të përqendruar. Për këtë qëllim, OQB të verifikojë përputhshmërinë e kërkesave të dërguara nga autoritetet kontraktore me ligjin dhe standardet në fuqi, duke bashkërenduar punën në përlllogaritjet e të dhënave sasiore për mallrat, që do të prokurohen para publikimit të tenderit, dhe duke synuar efektivitetin e fondeve të punojë për të përcaktuar kostot standarde të shërbimeve, bazë kjo më pas për të vlerësuar dhe kontrolluar përcaktimin e fondit limit nga AK

Vazhdimisht

11. Nga mbikëqyrja e auditimeve të kryera nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm, u konstatua se prej saj nuk ishte parashikuar dhe realizuar, kryerje auditimi për zbatimin e detyrave të lëna në kontrollet e mëparshme.

Për këtë është rekomanduar:

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm të parashikoj në planin vjetor, si dhe të kryej auditime të veçanta gjatë vitit për zbatimin e detyrave të lëna në kontrollet e mëparshme.

Vazhdimisht

12. Në MPB ekziston Rregullorja e Brendshme, e cila bazohet në kuadrin ligjor ekzistues mbi etikën, konfliktin e interesit, por në të nuk janë përfshirë detyrimet për strukturat e Policisë së Shtetit, Gardën e Republikës, Prefekturat, Rezervën Materiale të Shtetit, si dhe struktura të tjera në varësi të Ministrisë.

Për këtë është rekomanduar:

MPB në bashkëpunim me strukturat e tjera në vartësi të saj, të përfundojë “Rregulloren e Brendshme”, duke përfshirë detyrimet dhe vendosjen e linjave të raportimit edhe për strukturat e Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Prefekturave, Rezervës Materiale të

Shtetit dhe strukturave të tjera në varësi të Ministrisë, këto në kuadrin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm.

Brenda datës 30/06/2015

13. Faturat e energjisë elektrike, të ujësjellësit dhe shërbimet postare, nuk kishin nënshkrimet e blerësit në faturat e tyre, por u jepej rrugë likuidimi nëpërmjet faturave elektronike pa u nënshkruar më parë nga struktura menaxhuese përkatëse e MPB. Po kështu, urdhër shpenzimet për likuidimin e “Shërbim konektiviteti-Rrjeti i komunikimeve on line për shërbimin në Gjendjen Civile” për subjektin “A.c”, që shoqëroheshin me proces verbalet e marrjes në dorëzim të këtij shërbimi, ishin shuma faqe për çdo likuidim dhe për një sërë nën/shërbimesh të kontraktuara, në të cilat komisioni i marrjes në dorëzim, ka firmosur vetëm në faqen e fundit, duke lënë shteg për abuzime financiare.

Për këtë është rekomanduar:

Dega e Financës të mos kalojë asnjë urdhër shpenzimi pa u nënshkruar më parë nga strukturat menaxhuese të MPB, faturat mujore të energjisë elektrike, telefonisë fikse, shërbimit postar dhe ujësjellësit etj. Për likuidimin e subjektit “A.c”, marrja në dorëzim e këtij shërbimi dhe nënshkrimi i tij nga komisioni i marrjes në dorëzim, të jenë në përputhje me udhëzimin Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësinë e sektorit publik”.

Vazhdimisht

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

Gjatë auditimit të procedurës së zhvillimit të tenderit me objekt:

1. “Blerje pjesë ndërrimi për automjete për shërbimet profilaktike” loti i II “Goma”, KVO i përbërë nga V.K. kryetare, E.P., E.S., Ea.S dhe Y.P anëtarë, ka skualifikuar padrejtësisht BOE “CAA” sh.p.k. & “Gajd” sh.p.k. me ofertë 7,526,666 lekë më të ulët, se sa OE “R “ sh.p.k, i cili është shpallur fitues.

Skualifikimi i kryer është në kundërshtim me vet KVK të miratuara me DS të tenderit, si dhe përcaktimet e parashikuara në nenin 1 "Objekti dhe qëllimi", të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar dhe ngarkon me përgjegjësi KVO.

Për këtë është rekomanduar:

Të merren masat dhe të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës **7,526,666 lekë**, ose 1,505,333 lekë/secili, nga anëtarët e KVO, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, në të gjitha shkallët e gjykimit.

Menjëherë

2. “Blerje tonerë” me fond limit 104,674 mijë lekë, KVO kanë skualifikuar OE “M.d.” sh.p.k, me ofertë 16,102,785 lekë më të ulët se sa OE “Io” sh.p.k. i cili është kualifikuar dhe është shpallur fitues.

Nga auditimi dokumentacionit rezulton se të dy OE kanë të njëjtën parregullsi, ju mungon “Autorizim prodhuesi”.

Në këtë rast KVO duhet të s'kualifikonte edhe OE "I o" sh.p.k. Në fakt KVO ka mbajtur standard të dyfishtë, për të njëjtën parregullsi, ka skualifikuar OE me ofertë më të ulët dhe ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE me ofertë më të lartë.

Nën këtë arsye diferencë prej 16,102,785 lekë midis ofertave të të dy OE përbën dëm ekonomik dhe ngarkon me përgjegjësi KVO.

Kualifikimet e kryera janë të papajtueshme me KVK, kërkesat specifike të përcaktuara në DST, pasi cenojnë përcaktimet e parashikuara në nenin 1 "Objekti dhe qëllimi", të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar. Në këto kushte, KVO i OQB, duhet të skualifikonte OE që i ka shpallur fitues dhe në mungesë të një ofertë të vlefshme, në mbështetje të nenit 24/ç të ligjit 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar, në të cilën është përcaktuar se procedura e tenderit **anulohet** ... nëse asnjë nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe zbatim të pikës 1 të Kreu-^t të VII të VKM nr. 1, datë 10.1.2007 i ndryshuar, ... autoriteti kontraktor ... fillon një procedurë të re ...

Për këtë është rekomanduar:

Të merren masat dhe të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës **16,102,785 lekë**, ose 3,220,557 lekë/secili, nga anëtarët e KVO, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, në të gjitha shkallët e gjykimit.

Për tenderët në vijim përsëritet i njëjti fenomen. OE kanë mangësi në dokumentacion, por njeri prej tyre, ai me ofertë ekonomike më të lartë kualifikohet dhe shpallet fitues, kurse OE me parregullsi të njëjtë, ose të ngjashme, por me ofertë ekonomike më të ulët, është skualifikuar.

3. Për shkeljet në tenderin "Blerje uniformash, veshmbathje dhe elementë të tjerë, përbërës të tyre" loti I me fond limit 50,714 mijë lekë, pasi kanë skualifikuar OE me ofertë 15,241,292 lekë më të ulët se sa OE i shpallur fitues.

Argumentim:

Tenderi është i organizuar në tre lote

Loti i parë "Materiale të buta dhe veshmbathje" me vlerë 50,714,258 lekë,

“ dytë "Uniforma të Gardës së Republikës" “ “ 15,485,334 “

“ tretë "Drejtoria e Përgjithshme Detare" “ “ 1,240,270 “

Në dy lotet e tjerë ka marrë pjesë një OE, i cili është shpallur dhe fitues.

Pas verifikimit në sistemin e APP të dokumentacionit ligjor e administrativ kualifikues të operatorëve ekonomikë (OE) pjesëmarrës në tender, u konstatua se në lotin e parë kanë marrë pjesë:

Nr	Operatorët ekonomikë	Njësia e matjes	Ofertat ekonomike		
			Pa TVSh	Me TVSh	
1	A3 sh.p.k.	000 lekë	36,582,400	43,898,880	s'kualifikohet
2	BOE A & L sh.p.k.	” ”	44,647,530	53,577,036	”
3	E sh.p.k.	” ”	47,942,970	57,531,564	”
4	BOE "E & "Gj"	” ”	49,283,477	59,140,172	Fitues

KVO ka skualifikuar OE "A 3" sh.p.k, BOE "AR" sh.p.k. & "L" sh.p.k. dhe OE "E" sh.p.k. me argumentimin se ... Fletë analiza e paraqitur ... nuk është në përputhje me specifikimet

teknike për artikujt ... Në vijim jepen 10 artikujt që nuk plotësojnë cilësinë e kërkuar. Analizat janë kryer në “Laboratorin fiziko – mekanik dhe kimik të tekstilit dhe lëkurës” në Departamentin e Tekstilit dhe Modës, të Universitetit Politeknik të Tiranës (i vetmi në vend).

Në KVK, në pikën 2.4. “Kërkesa specifike” për lotin e parë është përcaktuar se ... OE që konkurren për lotin e parë duhet të paraqesë Raport analizë të kryer nga laboratorë të akredituar në Republikën e Shqipërisë... për treguesit fiziko – mekanik të lëndës së parë të përdorur vetëm për artikujt e listuar. Për këtë lot janë kërkuar **18 analiza gjithsej**.

U verifikua në sistemin elektronik të APP dokumentacioni ligjor e administrativ kualifikues i BOE “E” & ”Gj” sh.p.k. (OE ”E” sh.p.k. ka 58 për qind të realizimit të kontratës, kurse ”Gj” sh.p.k. ka 48 për qind të realizimit proporcionalisht për të gjithë produktet) fitues dhe u konstatua se:

1. Certifikata e që vërteton cilësinë e menaxhimit të shoqërisë ... ISO 9001-2008 e paraqitur nga OE “Gj” sh.p.k. **nuk është e rregullt**, pasi afati i vlefshmërisë së saj është deri datë 9 prill 2014, ndërkohë që tenderi do të zhvillohet datë 16.5.2014, në kundërshtim me pikën 2.4.4 të KVK të shtojcës & të DST.
2. Në të gjitha “Raportet e testimi” (analizat) të paraqitura, laboratorit është shprehur vetëm për një tregues, atë të përbërjes, në kundërshtim me pikën 2.4.1. të KVK të Shtojcës 7 në të cilën është përcaktuar se ... *OE duhet të paraqesë raport analizë ...për treguesit fiziko-mekanik e kimik të lëndës së parë të përdorur (rreth 16 tregues).*
3. Furnizimet e ngjashme të realizuara për lotin e parë “Blerje materiale të buta dhe veshmbathje” me vlerë 23,480,000 lekë nga subjekti privat “A” sh.p.k. nuk është e shoqëruar me faturat tatimore të shitjes, në kundërshtim me pikën 2.3.1.a të KVK.
4. “Autorizim prodhuesi” i lëshuar nga vet BOE, sipas të cilit ... *Të butat, veshmbathje ... (të tre lotet) do të jenë prodhime të firmës “E” sh.p.k. dhe “Gj” sh.p.k. sipas specifikimeve teknike të DT. Deklarata e origjinës e paraqitur nga BOE, sipas së cilës ... origjina e materialeve të buta .. etj, do të jenë të firmës “E” sh.p.k. dhe “Gj” sh.p.k.*

Deklarata për cilësinë e BOE, sipas së cilës ... *të gjithë artikujt ... janë të cilësisë së parë dhe këtë e vërtetojmë me Raport analizën e të gjithë lëndëve të para të përdorura...,* komprometohet, pasi: OE “G” sh.p.k. nuk ka certifikatë ISO 9001-2008 (pika 1), kriteri i vendosur në pikën 2.4. të KVK, kërkon “Autorizim prodhuesi”, nga prodhuesi i lëndës së parë, ndërkohë që BOE nuk është prodhues i lëndës së parë, por është përdorues i saj. Gjithashtu theksojmë se “Raporti i testimi” i lëshuar nga laboratorit ka përcaktuar se ... *i përket vetëm kampionit që i është nënshtruar provës.* Në këtë situatë mungon lidhja midis kampionit të lëndës së parë që i është nënshtruar “Raportit të testimi” të kryer nga Laboratorit, me lëndën e parë që do të përdoret për prodhimin e artikujve. Kampionin e ka marrë dhe paraqitur në laborator, vet BOE.

Nisur nga sa më sipër KVO duhet të s’kualifikonte edhe BOE “E” & ”Gj” sh.p.k. dhe duke qenë që të gjithë operatorët ekonomik nuk plotësojnë kriteret, pranimi i një oferte më të lartë ka shkaktuar minimalisht efekt negativ në buxhetin e shtetit për diferencën me operatorin me vlerë më të ulët të skualifikuar, në këtë rast në vlerën 15,241,292 lekë, midis ofertës të OE “A3 ” sh.p.k dhe BOE “E” & ”Gj” sh.p.k. Për këtë kemi ngarkuar me përgjegjësi KVO.

4. Për shkeljet në tenderin me objekt “Blerje automjete speciale për Ministrinë e Mbrojtjes” me fond limit 25,833 mijë lekë. Objekt i tenderit është një makinë borëpastruese dhe një pirun (vinç). Në sistemin elektronik të APP, u konstatua se kanë marrë pjesë OE:

Nr	Operatorët ekonomikë	Njësia e matjes	Ofertat ekonomike		
			Pa TVSh	Me TVSH	
1	An	Lekë	25,100		s'kualifikohet
2	St	”	25,200		”
3	M.B.	”	25,400		”
4	RR	”	25,700		Fitues
5	Si	”	25,800	30,960	s'kualifikuar
6	Al	”	25,833		”

KVO ka skualifikuar OE “An” sh.p.k, “St” sh.p.k. & “MB ” sh.p.k. dhe “Si” kryesisht për mungesa në dokumentacionin ligjor administrativ kualifikues, të cilat pas verifikimit rezultojnë të drejta.

Nga auditimi u konstatua se edhe OE “RR” sh.p.k. fitues i tenderit nuk plotëson kriteret e përcaktuara në KVK, pasi tek furnizime të ngjashme me objektin e prokurimit, paraqitur nga OE “RR” sh.p.k. nuk gjenden përputhje me kërkesat e pikës 2.3 “kapaciteti teknik” të KVK të DST. Kështu për *punime të ngjashme me objektin e prokurimit* janë paraqitur një kokë trajleri me vleftë 23,000 mijë lekë dhe një kamion vinç me vlerë 3,504 mijë lekë, të cilët nuk plotësojnë kriterin e kërkuar.

Në KVK është përcaktuar furnizime të ngjashme me objektin e prokurimit me vlerë 10,333 mijë lekë.

Mungonte në stafin e vet të vërtetuar me listë pagesat për periudhën janar - shtator 2014, një inxhinier mekanik ... fakt që bie në kundërshtim me pikën 2.4.6. të KVK.

OE “RR” sh.p.k. ka paraqitur listë pagesë vetëm për muajin **tetor 2014**, ndërkohë që është kërkuar që ofertuesi ... *duhet të ketë në stafin e tij një inxhinier mekanik ... dhe duhet të paraqesë diplomën e inxhinierit teknik ... si dhe listë pagesat për periudhën **janar – shtator 2014**.*

Mungon deklarata origjinale të garancisë (e prodhuesit) për mallrat që ofron, në kundërshtim me pikën 2.4.4. të KVK.

OE “RR” sh.p.k. si dokument origjinal të garancisë ka paraqitur një “Deklaratë garancie” të lëshuar nga vet OE “RR” sh.p.k.

Gjithashtu si autorizime prodhuesi ka paraqitur një fotokopje në anglisht lëshuar nga:

- Duty Truck me datë 5.11.2014 për mjetin borëpastruese ..., të notuar datë 8.11.2014 me shënimin nga noteri ... *vërtetohet përkthimi i dokumentit bashkëngjitur* (jo nga origjinali. Normalisht noteri shprehet përkthyer nga origjinali).

- Global Poëer LID me datë 5.11.2014 për mjetin pirun ngarkues ..., të notuar datë 8.11.2014 me shënimin ... *vërtetohet përkthimi i dokumentit bashkëngjitur* (jo nga origjinali).

Nga verifikimi i dokumentacionit fizik të sjellë nga OE “RR” sh.p.k. konstatohet se autorizimet nuk janë origjinale.

Nuk ka paraqitur një specialist të specializuar nga fabrika prodhuese, i cili do të trajnojë stafin për secilin nga automjetet, në kundërshtim me pikën 2.4.9. të KVK.

OE “RR” sh.p.k. si dokument CV ka paraqitur fotokopje anglisht të lëshuar nga Gl me datë 6.11.2014 për një person, i cili kryen disa detyra në kompani, por jo trajnues, me shënimin e noterit ... *vërtetohet përkthimi i dokumentit bashkëngjitur* (jo nga origjinali).

Në fund të dokumentit, firma dhe vula është data 8 nëntor. Konstatohet se dokumenti është lëshuar njëkohësisht datë 8 nëntor në Kinë dhe po në datë 8 nëntor 2014 është noterizuar në Shqipëri.

Ndërsa nga D Tk me po të njëjtën datë paraqitur CV për një person, i cili kryen disa detyra në kompani, por jo trajnuet, me shënimin ... *vërtetohet përkthimi i dokumentit bashkëngjitur* (jo nga origjinali), edhe në këtë rast dokumenti është lëshuar njëkohësisht datë 6 nëntor 8 nëntor në Kinë dhe në datë 8 nëntor 2014 është noterizuar.

Në të dy rastet nuk vërtetohet se janë specialistë për qëllimin e kërkuar dhe në asnjë rast nuk shprehen se marrin përsipër trajnimin e stafit që do të përdorë mjetet. Mungon lidhja midis kërkesës që ka AK për trajnimin e stafit që do të drejtoj pirunin, me CV e paraqitura. Sa më sipër është shoqëruar me një deklaratë nga OE "RR" sh.p.k. sipas së cilës ... *shoqëria jonë (OE "RR" sh.p.k.) merr përsipër trajnimin e stafit i cili do të drejtojë mjetet ...*

Nga verifikimi i dokumentacionit fizik të sjellë nga OE "RR" sh.p.k. konstatohet se autorizimet nuk janë origjinale.

Ka mospërputhje midis afatit të lëvrimit të mallit nga momenti i lidhjes së kontratës, i cili në specifikimet teknike të sjella nga OE "RR" sh.p.k. është përcaktuar 30 ditë, kurse në deklaratimet e bëra nga shoqëritë kineze afati i lëvrimit është përcaktuar 90 ditë, në kundërshtim me shtojcën 10 pjesë e DST të tenderit.

Deklarimet e shoqërive kineze kanë mangësi pasi:

- Nuk janë origjinale,
- Nuk janë të adresuara, për cilin institucion, tender etj.
- Deklarimi i lëshuar nga kompania "Duty Truck ...", nuk ka datë, kurse deklaratat e përkthyer dhe noterizuar ka datë 5.11.2014.

Certifikata e konformitetit e paraqitur nga "D Tk ..." Kinë, nuk është e rregullt, në kundërshtim me 2.4.8. të KVK, pasi është një deklaratë personale e shoqërisë kineze, fotokopje, sipas së cilës ... *produktet e tyre si borëpastrues ... janë vlerësuar me certifikatë për përputhje me normat standarde të BE*. Në KVK është kërkuar certifikatë konformiteti për automjetet që do të ofertohen. OE "RR" sh.p.k. ka paraqitur si Certifikatë Konformiteti, një dokument të lëshuar nga Bullgaria, jo origjinal, i cili është noterizuar *vetëm* për përkthimin (jo për origjinalin).

Në paragrafin e fundit të saj është shprehur se ... *kjo certifikatë konformiteti është bazuar vetëm në vlerësimin e dosjes teknike të produkteve ... dhe nuk përfshin një vlerësim të produktit*. **Ky paragraf komprometon certifikatën e konformitetit.**

Katalogu i paraqitur për mjetin borëpastrues është një faqe në të cilin jepet një përshkrim kryesisht për funksionin e mjetit, por nuk jep asnjë hollësi teknike. Për mjetin pirun janë përkthyer disa specifikime teknike, por me ndryshime dhe tregues të paqartë ndaj kërkesave që ka paraqitur AK.

Nisur nga parregullsitë e evidentuara, KVO duhet të skualifikonte OE "RR" sh.p.k. Parregullsitë e konstatuara ngarkojnë me përgjegjësi KVO. Diferenca në vlerë prej 500,000 lekë, midis ofertës të OE "St dhe OE "RR" sh.p.k. përbën efekt negativ në buxhetin e shtetit dhe ngarkon me përgjegjësi KVO.

5. Për shkeljet në tenderin me objekt "*Blerje Fuoristrada & Mikrobusë*" për Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit (DPPSH), loti i parë, me fond limit 169,596 mijë lekë, me fitues OE "HA", me ofertë ekonomike 169,176,000 lekë, kanë skualifikuar OE "Av", me ofertë ekonomike 40,795,628 lekë më të ulët se sa OE i shpallur fitues, i cili nuk ka konkurruar plotësisht për lotin e parë, pasi nuk ka sjellë ofertë ekonomike për 4 automjete tip Fouristradë, pasi ky lot përbëhet nga 40 Mikrobusë dhe 4 Fouristrada.

Nga DPPSH janë bërë llogaritjet e fondeve limit për çdo automjet, ndërsa ndarjet në lote janë bërë nga Drejtoria e Përqendruar e Prokurimeve Publike të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Në këtë blerje është edhe një kërkesë nga institucioni i Shëndetit Publik Tiranë për një Fouristrad me fond limit 1,233,858 lekë. Drejtoria e Përqendruar e Prokurimeve Publike ka bërë vetë këtë ndarje në lote, e konkretisht:

Loti i parë “Blerje Fouristrada & Mikrobusë për DPPSH, me fond limit total prej 141,330,000 lekë për 44 automjete gjithsej;

Loti i dytë “Blerje Mikrobusë 4x4 dhe ambulanca”, DPPSH, me sasinë respektivisht 15 Mikrobusë dhe 2 Ambulanca, me vlerë totale fond limit 95,666,667 lekë;

Loti pestë “Blerje Fouristrada” 4x4 për 1 copë me fond limit 1,233,858 lekë.

Nga grupi i auditimit u bë auditimit i vetëm lotit të parë “Blerje Fouristrada & Mikrobusë”. Ndarja në lote nuk është konformë VKM nr. 1, datë 10/01/2007, me ndryshimet, Kreu II-Rregullat e përgjithshme të prokurimit, pika 2 “Llogaritja e vlerës së kontratës”, germa (dh), ku cilëson shumë qartë se si mund të bëhet ndarja në lote, e konkretisht: *“Kontrata ndahet në lote, kur përbëhet nga mallra....., homogjene ose të ngjashme, dhe kur vlera e kombinuar është e tillë që vetëm një numër i vogël operatorësh ekonomikë do të ishin në gjendje t'i siguronin ato. Kjo mënyrë mund të përdoret veçanërisht për të nxitur pjesëmarrjen e biznesit, të vogël e të mesëm, apo për të ulur kostot administrative të autoritetit kontraktor.....”*.

Pra, loti i parë për “Fouristrada & Mikrobusë” nuk janë mallra homogjen ose të ngjashme si dhe këto mallra nuk i prodhon vetëm një numër i vogël operatorësh ekonomik për ti siguruar, por ka shumë operatorë që i prodhojnë. Madje mund të ishte bërë lot më vet Fouristradat dhe më vete Mikrobusë, pasi në lotin e parë ka Fouristrada, që duhej të ishte bashkuar me lotin nr. 5, sepse ka vetëm Fouristrada.

Po kështu loti i parë ka Mikrobusë dhe duhej bashkuar me lotin e dytë që ka blerje 15 copë Mikrobusë, pasi konstatojmë që specifikimet teknike të mikrobusëve të dy loteve janë pothuaj të njëjtë (ndryshojnë vetëm përmasat). Ndërkohë që kombinimi i tyre me automjete që nuk afrohen as me specifikimet teknike të tyre dhe as me përdorimin vë në dyshim dëshirën e mirë për të siguruar mallra cilësorë dhe duke i përdorur me efektivitet fondet në dispozicion. Nga ana tjetër konstatohet lehtësisht se të dy tipet e mikrobusëve janë siguruar me çmime të ndryshme dhe me diferencë të madhe nga njëri tjetri, pavarësisht se karakteristikat teknike i kanë të njëjta.

Kjo ndarje e gabuar në lote ka influencuar gjatë hapjes së procedurës së tenderit duke sjellë edhe vështirësi, sepse një konkurrent për lotin e parë ka paraqitur ofertë ekonomike vetëm për 40 Mikrobusë, ndërsa për 4 Fouristrada nuk ka paraqitur ofertë ekonomike. Mirëpo oferta ekonomike e 40 Mikrobusëve e konkurrentit të skualifikuar (vetëm përse nuk ka sjellë ofertë për 4 Fouristrada) është shumë më e ulët se atij të shpallur fitues, i cili ka paraqitur ofertat e të dy llojeve të automjeteve.

E parë në një kontekst më të gjerë atë të përdorimit me efektivitet të fondeve theksojmë se një bashkim i tillë mekanik, pa vënë në dyshim qëllimin e mirë të KVO, ka shkaktuar një impakt negativ në buxhetin e shtetit për vlerën prej 40,795,628 lekë. Në këtë rast gjykojmë se parregullsitë e konstatuara ngarkojnë me përgjegjësi **Njësinë e prokurimit**.

6. Për shkeljet në tenderin me objekt “Blerje pajisje elektronike dhe telekomunikacioni” loti tretë - Blerje Projektorë, me fond limit me tvsh 1,150,200 lekë, me vlerë fituesi “B”, prej 762,300 lekë, pasi kanë skualifikuar OE me ofertë ekonomike 92,340 lekë më të ulët se sa OE i shpallur fitues. Në përfundim të auditimit, sipas verifikimit të platformës elektronike kanë paraqitur interesa për të marrë pjesë në këtë lot 6 konkurrent si: “F”; “A-S”; “Co”; “B”; “Ju” dhe “Io”. Nga këto 6 konkurrent të interesuar kanë hedhur dokumente në ditën dhe orën e caktuar për zhvillim tenderi 5 konkurrent, ndërsa 1 konkurrent si “Al” nuk i ka hedhur dokumentet. Sipas verifikimit në platformën elektronike, KVO-ja ka skualifikuar 2 operator ekonomik konkurrues e pjesëmarrës në tender, operatorin ekonomik “F”, me ofertë ekonomike në vlerën me tvsh prej 669,960 lekë, me këto argumentimin se nuk përmbush pikën 2.2 “kapacitetit teknik”, furnizimet të ngjashme të realizuara gjatë 3 viteve të fundit financiar, nuk ka paraqitur grafikun e lëvrimit dhe nuk ka paraqitur tabelat sipas autoriteteve kontraktore, për sasi të dhe vlerat e mallrave.

Konkurenti “F” ka bërë ankesë pranë autoritetit kontraktor, por autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje negative, duke dhënë edhe një shpjegim të gabuar me shkresën nr. 1178/1, datë 25/11/2014 se “në kontratat e ngjashme të paraqitura, rezultojnë se 3 prej tyre janë të lidhura në vitin 2014”.

Në këtë rast, sipas mendimit të grupit të auditimit, KVO-ja nuk ka vepruar drejt, pasi njësia e prokurimit për furnizimet e mëparshme të ngjashme nuk ka cilësuar për vitet 2011,2012 dhe 2013, por është cilësuar thjeshtë “3 vitet e fundit financiar”, ku me vit financiar nuk kuptojmë vit kalendarik, por kuptojmë vit financiar deri tek periudha e datës së zhvillimit të tenderit. Gabimi i KVO-së është se fillimisht nuk janë cilësuar vitet 2011, 2012 dhe 2103, por është cilësuar thjeshtë 3 vitet e fundit financiar. Theksojmë se nuk ka vepruar me të njëjtat standarde si për lotin e kompjuterëve, që fituesi i tenderit ka pasur edhe kontrata të mëparshme të vitit 2014 dhe nuk ka kryer të njëjtin veprim si me këtë konkurrent.

Ndërsa për pikat e dytë dhe tretë, KVO-ja ka vepruar drejtë, megjithatë duhej të kishte bërë një analizë veprimesh mes fituesit të kualifikuar dhe këtij konkurenti, pasi edhe vetë fituesi i tenderit “B” nuk i ka plotësuar 100% kërkesat kualifikuese, pasi konstatohet se në pikën nr. 2 të Kriteve të Përgjithshme, germa (a) është kërkuar dokumenti që vërteton se konkurenti ka plotësuar detyrimet fiskale, të lëshuar nga Administrata Tatimore, ndërkohë që në shkresën nr. 15100/2, datë 13/10/2014, të administratës tatimore, shpjegohet se ka detyrim (gjoba) në dëme pa tatim në vlerën prej **16,545,000 lekë**, që është edhe në proces apelimi dhe proces gjyqësor. Pra nuk e plotëson këtë kërkesë kualifikuese, sepse sipas legjislacionit të prokurimit publik në fuqi sqaron shumë qartë se kërkon dokument që ka plotësuar detyrimet fiskale. Gjithashtu për të gjitha furnizimet e mëparshme, të ngjashme, nuk paraqitet plotësisht me dokumentacione të rregullta, pasi vërtetimi i paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor Tiranë, nuk ka të cilësuar datën, shumat dhe sasi të e mallrave të furnizuara apo praktika dokumentare për furnizimet e KESH-it, rezulton se kontrata është e muajit Janar 2014, në një kohë që dokumentet janë kërkuar vetëm për vitet 2012 e 2013 **(duhej pranuar me të njëjtin standard, pasi për furnizime të tilla është skualifikuar konkurenti “F”)**. Edhe vërtetimi i paraqitur nga blerësi nuk ka të cilësuar datën, shumat dhe sasi të e mallrave të furnizuara, fatura tatimore e blerësit privat “Kristal” është pa vulë të shitësit si dhe pa emër, dhe nënshkrim të blerësit, praktikat dokumentare të ISKSH Tiranë, janë për një projekt shërbimi dhe jo blerje e furnizim mallrash, madje kontratat janë të periudhave para 3 viteve, (datat 01/04/2011 dhe Korrik 2011, kur tenderi është zhvilluar në muajin Nëntor 2014), edhe dy praktikat dokumentare të Rektoratit Tiranë, si kontrata datë 4/2/2014 është jashtë periudhës kohore të kërkuar nga njësia e prokurimit, pra nuk është kërkuar viti 2014 (duhej pranuar me të njëjtin standard, pasi për furnizime të tilla është

skualifikuar konkurenti “F”). Edhe vërtetimi i paraqitur nuk ka të cilësuar datën, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Gjithashtu në këto furnizime kemi edhe artikuj jashtë IT, si Televizor, Perde, Mikrofonat, Kamera, Kondicioner, etj., që shkojnë afërsisht rreth 2 milion lekë, vërtetimi i paraqitur nga blerësi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, nuk ka të cilësuar datën, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Pra, ky konkurrent i kualifikuar nga KVO-ja, nuk e plotëson vlerën e kërkuar për lotët pjesëmarrëse në tender, i cili ka marrë pjesë në 4 lote (III, IV, V, VI), që kanë vlerën e fondit limit rreth 131 milion lekë dhe kërkohet 30% të furnizimeve të mëparshme të ngjashme, pra rreth 39,3 milion lekë duhet të ketë furnizime të ngjashme. Në këto kushte KVO-ja duhet të kishte zbatuar nenin 53, pikën nr. 4, për devijimet e vogla, duke bërë krahasimet e operatorit ekonomik “F” dhe konkurrentit “B”, pasi edhe fituesi sipas kriterit të miratuar nga Njësia e prokurimit do të shpallej me çmim më të ulët dhe jemi para faktit se të dy konkurrentët nuk plotësojnë 100% kërkesat kualifikuese, porse jemi para faktit se operatori ekonomik “Fasterch” ka çmimin më të vogël. Skualifikimi i OE me ofertë ekonomike më të ulët përbën efekt negativ në buxhetin e shtetit *me efekt negativ prej 92,340 lekë.*

7. Për shkeljet në tenderin me objekt *“Blerje pajisje elektronike dhe telekomunikacioni-loti VI”- Blerje kompjuter, desktop, vorkstation, laptop* me fond limit 140,240,040 lekë, kanë skualifikuar OE “F”, me ofertë ekonomike 3,174,077 lekë më të ulët se sa OE i shpallur fitues, “B. Edhe ky lot ka të njëjtat mangësi si tek loti i cilësuar më lart, loti tretë Blerje Projektorë, pra arsytimi është i njëjtë por në këtë rast skualifikimi i operatorit ekonomik “F” me çmimin më të vogël, ka pasur një efekt negativ në buxhetin e shtetit *në vlerën prej 3,174,077 lekë.*

8. Për shkeljet në tenderin me objekt *“Blerje Certifikatash për Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile”*, me procedurë të hapur, me datë zhvillim tenderi 13/03/2014, me fond limit 14,999,999 lekë, me fitues OE “A”, në vlerën prej 14,340,600 lekë, kanë skualifikuar OE “A1”, me ofertë ekonomike 1,605,706 lekë më të ulët se sa OE i shpallur fitues. Sipas anëtarëve të KVO-së asnjë konkurrent nuk i plotëson kërkesat kualifikuese të miratuar nga Njësia e prokurimit. Konkurrenti i shpallur fitues ka paraqitur ankesë deri tek institucioni i Komisionit të Prokurimit Publik dhe ky institucion i ka kthyer përgjigje që duhet kualifikuar se nuk ka mangësi të mëdha.

Në këtë situatë KVO dhe Njësia e prokurimit duhet të kishte dërguar për ndjekje të mëtejshme, në zbatim të nenit 64/2 “Vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik”, pika 2, e LPP, me ndryshimet nr. 64/3 si dhe nenit 53 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 4, të LPP, me ndryshimet, që cilëson: *“Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë materialisht ose nuk devijojnë nga karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, apo gabime, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj”.*

Për sa më sipër, grupi i auditimit duke parë, që kriteri i vlerësimit të miratuar nga Njësia e Prokurimit, është *çmimi më i ulët* si dhe operatorët ekonomik të paraqitur në konkurrim nuk i plotësojnë 100% kërkesat kualifikuese, atëherë KVO-ja në këto kushte, tenderin duhet ta kishte anuluar dhe përsëritur nga e para, ose **në të kundërtën të kishte shpallur fitues konkurrentin që është paraqitur me çmim më të ulët**, duke u nisur edhe nga vendimi i marrë nga KPP, i cili nuk ka shpallur fitues ankimesin, por këtë e ka kualifikuar. Skualifikimi i OE me ofertë ekonomike më të ulët përbën efekt negativ në buxhetin e shtetit *me efekt negativ prej 1,605,706 lekë.*

Nga sa më sipër, rezulton se të dy OE kanë të njëjtën parregullsi, vetëm atë të “Autorizim prodhuesi”, i cili nuk plotësohet nga të dy OE. Në këtë rast KVO duhet të s’kualifikonte edhe OE “Io” sh.p.k. Në fakt KVO ka mbajtur standard të dyfishtë, për të njëjtën parregullsi, ka skualifikuar OE me ofertë më të ulët dhe ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE me ofertë më të lartë.

Kualifikimet e kryera janë të papajtuashme me KVK, kërkesat specifike të përcaktuara në DST, pasi cenojnë përcaktimet e parashikuara në nenin 1 "Objekti dhe qëllimi", të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar. Në këto kushte, KVO i OQB, duhet të skualifikonte OE që i ka shpallur fitues dhe në mungesë të një ofertë të vlefshme, në mbështetje të nenit 24/ç të ligjit 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar, në të cilën është përcaktuar se procedura e tenderit **anulohet** ... nëse asnjë nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe zbatim të pikës 1 të Kreu-^t të VII të VKM nr. 1, datë 10.1.2007 i ndryshuar, ... autoriteti kontraktor ... fillon një procedurë të re ...

Efekti negativ në buxhetin e shtetit, për të gjithë tenderët e përshkruar është 77,511,828 lekë gjithsej. Në formulimin “Efekt negativ në buxhetin e shtetit” janë përfshirë ato procedura tenderimi, në të cilat OE kanë mangësi në dokumentacion, por njeri prej tyre, ai me ofertë ekonomike më të lartë kualifikohet dhe shpallet fitues, kurse OE me parregullsi të njëjtë, ose të ngjashme, por me ofertë ekonomike më të ulët, është skualifikuar. Fondi limit për tenderët me efekt negativ në buxhet është 518,830 mijë lekë, ose rreth 15 për qind e fondit limit të tenderëve të audituar.

Zj. V.K. është pjesëmarrëse në të gjithë procedurat e tenderimit të përshkruar.

Zj. E.P. është pjesëmarrës në procedurën e tenderit me objekt “Blerje tonerë”, “Blerje certifikata”.

Zj. A.N. është pjesëmarrës në procedurën e tenderit me objekt “Blerje tonerë”, “Blerje uniformash, veshmbathje dhe elementë të tjerë, përbërës të tyre”, “Blerje pajisje elektronike” loti III.

Zj. J.Q, D.C. dhe A.H janë pjesëmarrës në procedurën e tenderit me objekt “Blerje Fuori strada & Mikrobusë”.

Z. A.K është pjesëmarrës në procedurën e tenderit me objekt “Blerje tonerë”, “Blerje uniformash, veshmbathje dhe elementë të tjerë, përbërës të tyre”, “Blerje pajisje elektronike loti III dhe VI.

Z. M.P është pjesëmarrës në procedurën e tenderit me objekt “Blerje tonerë”, “Blerje Fuoristrada & Mikrobusë”, “Blerje pajisje elektronike” loti III,

Z. A.J “Blerje uniformash, veshmbathje dhe elementë të tjerë, përbërës të tyre”.

Z. Y.P është pjesëmarrës në procedurën e tenderit me objekt “Blerje uniformash, veshmbathje dhe elementë të tjerë, përbërës të tyre”, “Blerje pajisje elektronike” loti III, “Blerje automjete speciale për Ministrinë e Mbrojtjes.

Z. A.Gj dhe A.Z. janë pjesëmarrës në procedurën e tenderit me objekt “Blerje pajisje elektronike” loti III dhe loti i VI.

Zj. Ea.S është pjesëmarrës në procedurën e tenderit me objekt “Blerje automjete speciale për Ministrinë e Mbrojtjes”.

2. Gjatë auditimit të pagesave në zbatim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë për punonjësit që u janë ndërprerë marrëdhëniet e punës, u konstatua se për pagesat e kryera, ish punonjësve sipas (listës numër 1) të Raportit të Auditimit, nuk ju është ndalur vlera 5,132,135 lekë gjithsej, nga e cila 3,101,514 detyrim nga punëdhënësi dhe 2,036,621 lekë, detyrim nga punëmarrësi.

Për këtë është rekomanduar:

Institucioni i MPB në bashkëpunim me Institutin e Sigurimeve Shoqërore, të merren masa për të siguruar derdhjen në fondin e sigurimeve shoqërore të shumës së munguar prej **5,132,135 lekë**, për nivelin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, që duhet të derdheshin nga ekzekutimi i vendimeve gjyqësore

Menjëherë

3. Nisur nga dokumentacioni i pagesës së kryer zj. T.Sh, në zbatim të një vendimi gjyqësor të formës së prerë, u konstatua se për të njëjtën periudhë kohore, ish punonjësja e MPB ka përfituar pagesë në zbatim të vendimit të gjykatës deri në kthimin e saj në punë nga MPB dhe njëkohësisht nga punësimi në një institucion tjetër shtetëror. Pagesa e përfituar padrejtësisht është 1,177,551 lekë.

Për këtë është rekomanduar:

Të merren masat dhe të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës **1,177,551 lekë**, nga ish punonjësja Tatjana Shyrbi, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, në të gjitha shkallët e gjykimit.

Menjëherë

4. Gjatë auditimit të procedurës së tenderit me objekt “Blerje uniformash, veshmbathje etj”, OE pjesëmarrës në tender, sipas kriterëve të kërkuara nga MPB, kanë paraqitur analiza të ndryshme të kryera në “Laboratorin e akredituar”, të Universitetit Politeknik të Tiranës. Për kryerjen e këtyre analizave, sipas rregullores, më parë OE duhet të kenë paguar një tarifë të përcaktuar, për llogari të “Laboratorit akredituar”. U verifikua kryerja e kësaj pagese dhe rezultoi se në të ardhurat e Laboratorit mungojnë 580,000 lekë (vlera korresponduese e 58 analizave) që i takonin vetëm këtij tenderi, e cila përfaqëson shumën e paguar nga OE për analizat e paraqitura në tender e nën këtë arsytim kjo shumë, përbën dëm ekonomik dhe ngarkon me përgjegjësi z. Genti Guxho me detyrë përgjegjës i Laboratorit Fiziko-Mekanik dhe Kimik i Tekstilit dhe Lëkurës.

Për këtë është rekomanduar:

Universiteti Politeknik Tiranë, të marrë masat dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **580,000 lekë**, nga z. G.G me detyrë përgjegjës i Laboratorit Fiziko-Mekanik dhe Kimik, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, në të gjitha shkallët e gjykimit.

Menjëherë

B. MASA ADMINISTRATIVE

Për Agjencinë e Prokurimit Publik.

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në procesverbalet dhe aktverifikimet përkatës, vërejtjeve të subjektit të audituar dhe pjesës së Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Mbështetur në nenin 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, pikës 3, kreu X të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, neni 7, pika 2,3/a, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe bazuar në nenin 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, i **rekomandojmë Drejtorit të Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara**, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara, apo me rekomandimin e autoritetit kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), për personat si më poshtë:

1. V.K., në cilësinë e kryetares së KVO në 11 tenderë, si vijon:

- “Blerje Certifikata për Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile (DPGJC)”;
- “Blerje automjete” për Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit (DPPSSH) loti i parë; “Blerje Fuoristrada & Mikrobusë”;
- “Blerje automjetesh për INUK dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD)” loti I, “Blerje automjetesh për INUK”;
- “Blerje automjetesh për INUK dhe DPD loti II “Automjete për DPD”;
- “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi, për QSUT”;
- “Blerje pajisje elektronike dhe telekomunikacioni” Loti i II, “Blerje Skaneri”;
- “Blerje pajisje elektronike dhe telekomunikacioni” loti i III “Blerje Projektore”;
- “Blerje pajisje elektronike dhe telekomunikacioni” loti VI “Blerje kompjuter, desktop, workstation, laptop”;
- “Mirëmbajtja dhe Zhvillimi i Mëtejshëm i Regjistrimit Kombëtar të Gjendjes Civile”; - “Blerje automjete speciale për Ministrinë e Mbrojtjes”;
- “Blerje automjete speciale për Ministrinë e Mbrojtjes”.

2. M.P., në cilësinë e anëtarit të KVO, në 4 tenderë si vijon:

- “Blerje automjete për DPPSSH, loti I, “Blerje Fuoristrada & Mikrobusë”;
- “Blerje automjet për INUK dhe DPD” loti I, “Blerje automjete për INUK”;
- “Blerje automjetesh për INUK dhe DPD loti II, “Automjete për DPD”;
- “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi, (Katering) për QSUT”;

Në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit 4 tenderë, si vijon:

- “Blerje pajisje elektronike dhe telekomunikacioni” loti i II, “Blerje Skaneri”;
- “Blerje pajisje elektronike dhe telekomunikacioni” loti i III “Blerje Projektore”;
- “Blerje pajisje elektronike dhe telekomunikacioni” loti VI, “Blerje kompjuter, desktop, workstation, laptop”.
- “Pjesë ndërrimi për automjete për shërbime profilaktike”, tre lote.

3. Y.P., në cilësinë e anëtarit të KVO, në 6 tenderë si vijon:

- “Blerje automjetesh për DPPSSH, loti i I, “Blerje Fuoristrade & Mikrobusë”;
- “Blerje pajisje elektronike dhe telekomunikacioni” loti i II, “Blerje Skaneri”;
- “Blerje pajisje elektronike dhe telekomunikacioni” loti i tretë, “Blerje Projektore”;
- “Blerje pajisje elektronike dhe telekomunikacioni” loti i VI “Blerje kompjuter desktop, workstation, laptop”;
- “Mirëmbajtja dhe Zhvillimi i Mëtejshëm i RKGJC”;
- “Blerje automjete speciale për Ministrinë e Mbrojtjes”.

Në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit për 7 tenderë, si vijon:

- “Blerje automjete speciale për Ministrinë e Mbrojtjes”
- “Blerje certifikata për DPGJC”;
- “Blerje automjet për DPPSSH, aktualisht loti i I, “Blerje Fuoristrada & Mikrobus”;
- “Blerje automjete për INUK dhe DPD”, loti I “Blerje automjet për INUK”;
- “Blerje automjetesh për INUK dhe DPD, loti II “Automjete për DPD”;
- “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi, (Catering) për QSUT”;
- “Orendi dhe pajisje për mobilim zyresh”.

4. Ea.S, në cilësinë e anëtarit të KVO në 8 tenderë:

- “Blerje pajisje elektronike dhe telekomunikacioni”, Loti i dytë me objekt: “Blerje Skaneri”;
- “Blerje pajisje elektronike dhe telekomunikacioni-loti tretë-Blerje Projektore”;
- “Blerje pajisje elektronike dhe telekomunikacioni-loti VI-Blerje kompjuter, desktop, workstation, laptop”;
- “Mirëmbajtja dhe Zhvillimi i Mëtejshëm i Regjistrat Kombëtar të Gjendjes Civile”.
- “Blerje automjete speciale për Ministrinë e Mbrojtjes”
- “Blerje uniformash, veshmbathje dhe elementë të tjerë, përbërës të tyre”
- “Uniforma, veshmbathje dhe elemente të tjera”,
- “Blerje automjete speciale për Ministrinë e Mbrojtjes”.

5. A.G, në cilësinë e anëtarit të KVO në 4 tenderë, si vijon:

- “Blerje pajisje elektronike dhe telekomunikacioni”, loti i II “Blerje Skaneri”;
- “Blerje pajisje elektronike dhe telekomunikacioni” loti III “Blerje Projektore”;
- “Blerje pajisje elektronike dhe telekomunikacioni” loti VI “Blerje kompjuter, desktop, workstation, laptop”;
- “Mirëmbajtja dhe Zhvillimi i Mëtejshëm i RKGJC”;
- “Pjesë ndërrimi për automjete për shërbime profilaktike” tre lote, (anëtar i njësisë prokurimit)

6. E.P, në cilësinë anëtares së KVO në 3 tenderë, si vijon:

- “Blerje Certifikata për DPGJC”;
- “Blerje automjetesh për INUK dhe DPD”, loti I “Blerje automjete për INUK”;
- “Blerje automjete për INUK dhe DPD”, loti II “Blerje automjete për DPD”;

Në cilësinë e anëtares së njësisë së prokurimit në 1 tender:

- “Blerje uniformash, veshmbathje dhe elementë të tjerë, përbërës të tyre”,

7. A.J, në cilësinë e anëtares së KVO në 3 tenderë, si vijon:

- “Blerje automjetesh për INUK dhe DPD”, loti I “Blerje automjete për INUK”;
- “Blerje automjete për INUK dhe DPD” loti II “Automjete për DPD”;
- “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi, (Catering) për QSUT”;

8. E.Gj, në cilësinë e anëtarit të KVO në 3 tenderë, si vijon:

- “Blerje pajisje elektronike dhe telekomunikacioni”, loti i dytë “Blerje Skaneri”;
- “Blerje pajisje elektronike dhe telekomunikacioni” loti i tretë “Blerje Projektore”;
- “Blerje pajisje elektronike dhe telekomunikacioni” loti VI “Blerje kompjuter, desktop, workstation, laptop”.

9. A.Z, në cilësinë e anëtarit të KVO në 3 tenderë, si vijon:

- “Blerje pajisje elektronike dhe telekomunikacioni”, loti i dytë “Blerje Skaneri”;
- “Blerje pajisje elektronike dhe telekomunikacioni” loti i tretë “Blerje Projektorë”;
- “Blerje pajisje elektronike dhe telekomunikacioni-loti VI-Blerje kompjuter, desktop, vorkstation, laptop”.

10. A.N., në cilësinë e anëtares së KVO në 4 tenderë, si vijon:

- “Blerje pajisje elektronike dhe telekomunikacioni”, loti i dytë “Blerje Skaneri”;
- “Blerje pajisje elektronike dhe telekomunikacioni” loti III “Blerje Projektorë”;
- “Blerje pajisje elektronike dhe telekomunikacioni” loti VI “Blerje kompjuter, desktop, vorkstation, laptop”;

Në cilësinë e anëtares së njësisë së prokurimit në tenderin me objekt:

- “Orendi dhe pajisje për mobilim zyrash”.

11. E.S., në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit në 7 tenderë, si vijon:

- “Blerje automjete për DPPPSH, loti i I “Blerje Fuoristrada & Mikrobusë”;
- “Blerje automjete për INUK dhe DPD”, loti I “Blerje automjete për INUK”;
- “Blerje automjete për INUK dhe DPD” loti i II “Automjete për DPD”;
- “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi, (Catering) për QSUT”;
- “Blerje uniformash, veshmbathje dhe elementë të tjerë, përbërës të tyre”.
- “Blerje automjete speciale për Ministrinë e Mbrojtjes”;
- “Orendi dhe pajisje për mobilim zyrash”.

Për shkak se KVO:

- Ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE të ndryshëm, të cilët nuk i kanë plotësuar të gjithë kriteret e përcaktuar në DST në kundërshtim me vet KVK,

- Nuk ka hartuar procesverbalet në momentin e hapjeve së ofertave ekonomike nëpërmjet platformës elektronike nga KVO-të, me pasojë mos lënies së “gjurmës” se në cilën datë do të vazhdohet më tej procedura e vlerësimit të ofertave të OE pjesëmarrës etj, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10/01/2007 me ndryshimet, kreu v, pika 4, germa “c”;

- **Komisioni i vlerësimit të ofertave**, në procesin e vlerësimit dhe kualifikimit të dokumentacionit të OE, ka përdorur standard të dyfishtë. Për të njëjtat parregullsi në dokumentacion, ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE me ofertë më të lartë, ndërkohë që skualifikuar OE me ofertë më të ulët. Normalisht në këto kushte, duhet të anulonte dhe të përsëriste procedurën e tenderit.

Njësia e prokurimit:

- Në formulimin e kriterit për cilësinë dhe origjinën e mallrave, ka lënë vend për interpretime të gabuara nga KVO, pasi në përgjigje të këtij kriteri OE kanë paraqitur deklaratat personale në të cilat përgjithësisht janë shprehur se ... *mallrat e ofruar nga ne janë të cilësisë së parë dhe në përputhje të plotë me kërkesat e DT, Origjina e mallrave është nga Italia, Turqia dhe Kina*, dhe KVO i ka pranuar dhe konsideruar si të rregullta deklaratimet personale të OE. Njësia e prokurimit megjithëse ka qenë e pranishme në vlerësimet që ka bërë KVO, nuk ka ndërhyrë për korigjimin e kësaj pasaktësie, e cila ka ndikuar në procedurën e zhvillimit të tenderit (kualifikim/skualifikim të OE).

- Në tenderë të veçantë ka vendosur në KVK, kritere diskriminues, në kundërshtim me pikën 3 të Kap. III të VKM nr. 1, datë 10.01.2014 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar. Vendosja e kësaj kërkesë specifike në KVK, është në kundërshtim me vet përcaktimet e KVK, njëkohësisht, është në kundërshtim frymën e nenit 1 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, pasi:

ka orientuar me detyrim, që OE t’i marrin analizat vetëm te një laborator, duke e vendosur këtë të fundit në pozicion të privilegjuar, monopol ndaj të ngjashmëve dhe si tregon praktika, vendimtar në përcaktimin e OE fitues,

ka vendosur në pozicion diskriminues vullnetin e OE pjesëmarrës në tender dhe laboratorëve të tjerë që janë të licencuar për këtë qëllim.

- Në tenderin me objekt “Blerje automjete speciale për Ministrinë e Mbrojtjes”, nuk është dhënë mënyra e llogaritjes së fondit limit, në kundërshtim me pikën 2/c të Kreu-¹ të II të VKM nr. 1, datë të VKM nr. 1, datë 10.01.2014 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar. Specifikimet teknike të vendosura në DST janë të pasakta dhe japin mundësi për manipulimin e fondit limit etj.

Njësia e prokurimit megjithëse ka qenë e pranishme në vlerësimet që ka bërë KVO, nuk ka ndërhyrë për korrigjimin e kësaj pasaktësie, e cila ka ndikuar në procedurën e zhvillimit të tenderit (kualifikim/skualifikim të OE).

E. KALLËZIM PENAL

Bazuar në ligjin nr. 7905 datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar neni 281, ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, i sugjerojmë trajtimin e detajuar tekniko juridik nga ana e Drejtorisë Juridike dhe Zbatimit të Standardeve, të materialeve të evidentuara nga grupi i auditimit në kuptim të referencave të Kodit Penal, për personat si më poshtë:

1. **Znj. V.K.** me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Prokurimeve Publike
2. Znj. E.P,
3. Z. E.S.,
4. Znj. Ea S,
5. Z. Y.P.
6. Znj. A. N
7. Znj. J. Q,
8. Z. D.C.
9. Znj. A.H.
10. Z. A.K.
11. Z. M.P.
12. Z. A.J.
13. Z. E.Gj
14. Z. A.Z/
15. Zj. Eg. S

1. Për shkeljet e konstatuara në procedurën e tenderit “*Blerje pjesë ndërrimi për automjete për shërbimet profilaktike*” loti II me fond limit 37,456,892 lekë, *pasi kanë skualifikuar*

padrejtësisht BOE "C". & "G" sh.p.k. me ofertë 7,526,666 lekë më të ulët, se sa OE "R & R" sh.p.k. i shpallur fitues, e cila përbën **dëm ekonomik**. Gjykojmë se skualifikimi i kryer është në kundërshtim me vet KVK të miratuara me DS të tenderit, si dhe përcaktimet e parashikuara në nenin 1 "Objekti dhe qëllimi", të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar. Shpjegojmë, se për këtë procedurë kanë paraqitur ofertë OE:

Nr	Operatorët ekonomikë	Njësia e matjes	Ofertat ekonomike		
			Pa TVSh	Me TVSh	
1	BOE "C & G" sh.p.k.	Lekë	28,401,758	34,082,110	s'kualifikuar
2	"R R" sh.p.k.	"	34,673,980	41,608,776	Fitues
3	"Er"	"	36,885,400	44,262,480	s'kualifikuar
4	"F" sh.p.k.	"	37,016,550	44,419,860	s'kualifikuar

Për procedurën e zhvillimit të tenderit kanë paraqitur ankesë OE "ER" sh.p.k. dhe OE "F" sh.p.k, kundër OE "RR" sh.p.k, duke paditur se kjo shoqëri nuk ka plotësuar kriteret për kualifikim etj. Ankesa e tyre është shqyrtuar nga vet AK, Komisioni i Prokurimit Publik, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Njësia e Kontrollit të Brendshëm dhe Antikorrupsion, në Këshillin e Ministrave, të cilët nuk ju kanë dhënë të drejtë (bashkëngjitur është vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik, Prokurorisë të Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Njesisë së Kontrollit të Brendshëm dhe Antikorrupsion, në Këshillin e Ministrave për ankesat e bëra nga OE "Er" sh.p.k. dhe OE "F" sh.p.k, kundër OE "RR" sh.p.k).

BOE "C" & "G" sh.p.k. ka paraqitur ankesë vetëm në AK, për skualifikim të padrejtë të tij, i cili i ka kthyer përgjigje negative (bashkëngjitur është përgjigje që AK i ka kthyer ankesës bërë nga BOE "C". & "G" sh.p.k.).

Rezulton se KVO ka s'kualifikuar BOE "C" & "G" sh.p.k. me argumentimin (në sistemin elektronik) ... *Në kontratën e bashkëpunimit midis operatoreve ekonomik CAA dhe GAJD e noterizuar, nuk përcaktohen elementet konkrete që do të kryeje secili nga anëtarët e këtij bashkimi siç kërkohet shprehimisht ne VKM Nr. 1, date 10.01.2017 "Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar, kreu VII, pika 2, (b). Gjithashtu, ne ofertën ekonomike paraqitur nga bashkimi i operatoreve, nuk është përcaktuar pjesa e furnizimit që do të kryeje secili nga anëtarët a këtij bashkimi siç kërkohet shprehimisht ne VKM Nr. 1 Date 10.01.2007, i ndryshuar, kreu VII, pika 2, (a).*

Grupi i auditimit gjykon se ky arsyetim i KVO, **nuk qëndron**. Në akt marrëveshjen e bashkëpunimit datë 12.10.2014 lidhur midis palëve, në paragrafin "Kushtet e marrëveshjes" është përcaktuar se ... *shoqëria "C" sh.p.k. merr përsipër të kryejë 70 për qind të punimeve të tenderuar, ndërsa shoqëria G" sh.p.k. merr përsipër realizimin në masën 30 për qind të vlerës së përgjithshme të tenderit dhe po në këto raporte do të bëhet dhe shpërndarja e fitimit...* Nga sa më sipër konstatohet se në marrëveshje midis tyre OE "C" dhe "G" sh.p.k. janë shprehur qartë në zbatim të kushteve që parashikon pika 2 Kreu VII e VKM nr 1, datë 10.1.2007 "Për rregullat e prokurimit publik" i ndryshuar. "Elementët konkret" që ka kërkuar KVO, janë të vendosur drejtpërdrejtë në objektin e tenderit dhe janë vetëm një, "Goma për automjete". Mbështetur në sa më sipër KVO duhet të kualifikonte dhe të shpallte fitues të tenderit BOE "C" sh.p.k. dhe "G" sh.p.k, i cili ka paraqitur dhe ofertën më të ulët.

Nën këtë arsyetim, **vleftha prej 7,526,666 lekë**, që pasqyron diferencën midis ofertës të BOE "C" sh.p.k. & "G" sh.p.k. të skualifikuar padrejtësisht dhe OE "RR" sh.p.k. të shpallur fitues përbën **dëm ekonomik** dhe ngarkon me përgjegjësi KVO. Për këtë konkluzion të grupit të

auditimit, KVO ka bërë vërejtje, e cila përmbledhur sqaron se ... *Skualifikimi i BOE "C" sh.p.k. & "G" sh.p.k. është i drejtë. Duam të saktësojmë se të gjitha organet e përmendura në konstatimet tuaja ..., të cilat kanë kontrolluar ligjshmërinë e kësaj procedure prokurimi na kanë dhënë të drejtë me anë të shkresave ...BOE "C" sh.p.k. & "G" sh.p.k. nuk ka përqindjen dhe dhënë elementët konkretë të pjesëmarrësve etj ...*

Përsa më sipër vlen të theksohet se të shprehurit e KVO se ... *organet si KPP ... etj, na kanë dhënë të drejtë, nuk është i saktë.* Organet si Komisioni i Prokurimit Publik, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Njësia e Kontrollit të Brendshëm dhe Antikorrupsion, në Këshillin e Ministrave, janë shprehur vetëm për ankesat që OE "E" sh.p.k. dhe OE "F" sh.p.k, kanë bërë kundër OE "RR" sh.p.k, kurse problemi për të cilin është shprehur grupi i auditimit, është krejt tjetër. Më hollësisht argumentet e grupit të auditimit janë dhënë në procesverbalet përkatës, projektraport dhe raportin përfundimtar të auditimit.

2. Për shkeljet e konstatuara në procedurën e tenderit "Blerje tonerë" me fond limit 104,674 mijë lekë, kanë skualifikuar OE, me ofertë 16,102,785 lekë më të ulët se sa OE i shpallur fitues. Shpjegojmë, se për këtë procedurë kanë marrë pjesë OE:

Nr	Operatorët ekonomikë	Njësia e matjes	Ofertat ekonomike		
			Pa TVSh	Me TVSh	
1	M	lekë	-	-	s'kualifikuar
2	B"	"	"	"	"
3	Md	"	88,069,694	105,683,632	"
4	Io	"	101,488,681	121,786,417	Fitues

Konstatohet se KVO ka skualifikuar OE, M sh.p.k. dhe B sh.p.k me argumentin se *ka paraqitur vetëm ekstrakt të QKR.*

KVO e ka skualifikuar OE "Md" sh.p.k. me arsyetimin se ...

- Bilanci për vitin 2012 nuk është certifikuar pranë autoriteteve përkatëse tatimore.*
- Nuk është paraqitur Forma e Autorizimit të Prodhuesit (MAF); (Kontratat e paraqitura për këtë qëllim, janë kontrata të thjeshta furnizimi).*
- Gjatë shqyrtimit të ofertës ekonomike u konstatua se për artikuj të njëjtë është ofertuar me çmime të ndryshme. Konkretisht, çmimi i artikullit me numër rendor 438 në tabelën e përgjithshme të tonerëve është i ndryshëm nga çmimi i përcaktuar për këtë artikull në tabelën e Autoritetit Kontraktor Drejtoria e Policisë së Qarkut Fier i cili mban numrin rendor 33. Gjithashtu, në tabelën e Autoritetit Kontraktor Drejtoria e Shërbimit të Provës, kolona e çmimit pa TVSH nuk është e plotësuar. Kolonat e sasisë dhe të vlerës pa TVSH janë të plotësuar dhe nga përlllogaritja matematikore rezulton që çmimi pa TVSH i çdo artikulli në këtë tabelë të jetë i ndryshëm nga ai i përcaktuar në tabelën e përgjithshme të tonerëve.*

Nga verifikimi në sistemin e APP u konstatua se arsye e skualifikimit të OE "Mo" dhe "B" sh.p.k. është i drejtë.

Lidhur me shkaqet e skualifikimit të OE "Marketing & distribution" sh.p.k, sqarojmë se qëndron shkaku i skualifikimit sipas pikës a dhe b, por nuk qëndron shkaku i skualifikimit sipas pikës c. Vlehtë e këtij toneri është 5,615 lekë gjithsej, kurse diferenca midis çmimit të ofertës përmbledhëse dhe asaj të AK është akoma më e papërfillshme vetëm 0.006 për qind e vlerës së ofertës dhe KVO normalisht duhet ta trajtonte si gabim aritmetikor. Ndërkohë që sjellim në vëmendje që ky subjekt "Md" sh.p.k. ka qenë pjesëmarrës dhe është shpallur fitues në tenderin me objekt "Blerje letër dhe materiale kancelarie" i zhvilluar datë 1.4.2014. Në

Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të kërkuara nga AK është dhe ... *Bilanci për vitin 2012 i certifikuar pranë autoriteteve përkatëse tatimore.* Në sistemin elektronik të APP “bilanci i vitit 2012”, nuk është i certifikuar nga autoritetet tatimore, njëlloj si në tenderin për “Tonerë”, por në këtë rast AK nuk e ka skualifikuar OE “Md” sh.p.k, por ka kërkuar informacion, një kopje të certifikuar të bilancit të vitit 2012, nga Drejtoria Rajonale Tatimore, Tatim Paguesit e Mëdhenj. Kjo përgjigje ka mbërritur në MPB datë 18.4.2014, së bashku me një kopje të njehsuar të bilancit të vitit 2012 të shoqërisë “Md” sh.p.k, i cili është protokolluar në Drejtorinë Rajonale Tatimore me nr. 407, datë 29.3.2013. Mbi këtë bazë AK ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE “Md” sh.p.k. Për këtë tender, “Blerje letër dhe materiale kancelarie”, ka paraqitur ankesë OE “Io” sh.p.k., të cilit AK i ka kthyer përgjigje datë 30.4.2014 se *ankesa e tij për OE “Md të shpallur fitues nuk qëndron ... duke e konfirmuar këtë të fundit fitues të tenderit (në datë 18.4.2014 ka përfunduar vlerësimi i ofertave, kurse datë 13.5.2014 është hartuar raporti përmbledhës përfundimtar).*

Shpjegojmë që të dy tenderët janë zhvilluar në distancë një ditore dhe nga ana e KVO është ndjekur një standard i dyfishtë që ka sjell në rastin konkret diferencën që ne e konsideruam dëm ekonomik. Tenderi për “Blerje tonerë” është **zhvilluar datë 31.3.2014**. KVO në datë 17.4.2014 ka bërë vlerësimin, klasifikimin e OE dhe datë 5.5.2014 ka bërë “Raportin përmbledhës”, ndërkohë që tenderin me objekt “Blerje letër dhe materiale kancelarie” është zhvilluar më **datë 1.4.2014**.

Ndërkohë u verifikua në sistemin e APP dokumentacioni ligjor dhe administrativ kualifikues i OE “Infosoft officee” sh.p.k. të shpallur fitues dhe u konstatua se nuk është i plotë, në kundërshtim me pikën 2 paragrafi i tretë të shtojcës 7 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” (KVK) të DST, në të cilën është përcaktuar se *Operatori ekonomik të paraqesë Manufacturer Authorisation Form (Formën e Autorizimit të Prodhuesit), për tonerët e kërkuar në procedurë.* OE “Io **nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi**, për rrjedhojë duhet të ishte skualifikuar nga KVO. *Kështu OE “Io” sh.p.k. ka paraqitur si autorizim prodhuesi 17 dokumente të lëshuar nga subjekte të ndryshëm. Nga verifikimi i rregullsisë u konstatua se vetëm tre prej tyre mund të konsiderohen të saktë, kurse 13 dokumentet nuk janë “Autorizim prodhuesi”.*

Nga sa më sipër, rezulton se të dy OE kanë të njëjtën parregullsi, vetëm atë të “Autorizim prodhuesi”, i cili nuk plotësohet nga të dy OE. Në këtë rast KVO duhet të s’kualifikonte edhe OE “Io” sh.p.k. Në fakt KVO ka mbajtur standard të dyfishtë, për të njëjtën parregullsi, ka skualifikuar OE me ofertë më të ulët dhe ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE me ofertë më të lartë. Shpjegojmë se në kushtet që “Autorizim Prodhuesi” është me destinacion plotësisht të përcaktuar dhe përmban të gjithë të dhënat si Autoritetin kontraktor që zhvillon tenderin, të cilit i drejtohet autorizimi, objektin e tenderit “Tonerë”, autorizim për të ofertuar dhe për të lidhur kontratë, ai normalisht duhet të paraqitet origjinal, pasi nuk mund të përdoret, nuk është i vlefshëm për diku tjetër (është një përdorimsh).

Diferenca në vlerë prej 16,102,785 lekë, midis ofertës të OE “Md” sh.p.k dhe “Io” sh.p.k. përbën efekt negativ në buxhetin e shtetit dhe ngarkon me përgjegjësi KVO për standardin e dyfishtë në trajtimin e subjekteve në tender.

3. Për shkeljet në tenderin “Blerje uniformash, veshmbathje dhe elementë të tjerë, përbërës të tyre” loti I me fond limit 50,714 mijë lekë, pasi kanë skualifikuar OE me ofertë 15,241,292 lekë më të ulët se sa OE i shpallur fitues.

Argumentim:

Tenderi është i organizuar në tre lote

Loti i parë “Materiale të buta dhe veshmbathje” me vlerë 50,714,258 lekë,

“ dytë “Uniforma të Gardës së Republikës” “ “ 15,485,334 “

“ tretë “Drejtoria e Përgjithshme Detare” “ “ 1,240,270 “

Në dy lotet e tjerë ka marrë pjesë një OE, i cili është shpallur dhe fitues.

Pas verifikimit në sistemin e APP të dokumentacionit ligjor e administrativ kualifikues të operatorëve ekonomikë (OE) pjesëmarrës në tender, u konstatua se në lotin e parë kanë marrë pjesë:

Nr	Operatorët ekonomikë	Njësia e matjes	Ofertat ekonomike		
			Pa TVSh	Me TVSh	
1	A 3 sh.p.k.	000 lekë	36,582,400	43,898,880	s’kualifikohet
2	BOE A & L sh.p.k.	” ”	44,647,530	53,577,036	”
3	E sh.p.k.	” ”	47,942,970	57,531,564	”
4	BOE ”E” & ”Gj”	” ”	49,283,477	59,140,172	Fitues

KVO ka skualifikuar OE “A 3” sh.p.k, BOE “A& R” sh.p.k. & “L” sh.p.k. dhe OE “E” sh.p.k. me argumentimin se ... Fletë analiza e paraqitur ... nuk është në përputhje me specifikimet teknike për artikujt ... Në vijim jepen 10 artikujt që nuk plotësojnë cilësinë e kërkuar. Analizat janë kryer në “Laboratorin fiziko – mekanik dhe kimik të tekstit dhe lëkurës” në Departamentin e Tekstit dhe Modës, të Universitetit Politeknik të Tiranës (i vetmi në vend).

Në KVK, në pikën 2.4. “Kërkesa specifike” për lotin e parë është përcaktuar se ... OE që konkurron për lotin e parë duhet të paraqesë Raport analizë të kryer nga laboratorë të akredituar në Republikën e Shqipërisë... për treguesit fiziko – mekanik të lëndës së parë të përdorur vetëm për artikujt e listuar. Për këtë lot janë kërkuar **18 analiza gjithsej**.

U verifikua në sistemin elektronik të APP dokumentacioni ligjor e administrativ kualifikues i BOE “E” & ”Gj” sh.p.k. (OE ”E” sh.p.k. ka 58 për qind të realizimit të kontratës, kurse ”Gj” sh.p.k. ka 48 për qind të realizimit proporcionalisht për të gjithë produktet) fitues dhe u konstatua se:

1. Certifikata e që vërteton cilësinë e menaxhimit të shoqërisë ... ISO 9001-2008 e paraqitur nga OE “Gj” sh.p.k. **nuk është e rregullt**, pasi afati i vlefshmërisë së saj është deri datë 9 prill 2014, ndërkohë që tenderi do të zhvillohet datë 16.5.2014, në kundërshtim me pikën 2.4.4 të KVK të shtojcës & të DST.

2. Në të gjitha “Raportet e testimi” (analizat) të paraqitura, laboratorit është shprehur vetëm për një tregues, atë të përbërjes, në kundërshtim me pikën 2.4.1. të KVK të Shtojcës 7 në të cilën është përcaktuar se ... *OE duhet të paraqesë raport analizë ...për treguesit fiziko-mekanik e kimik të lëndës së parë të përdorur (rreth 16 tregues).*

3. Furnizimet e ngjashme të realizuara për lotin e parë “Blerje materiale të buta dhe veshmbathje” me vlerë 23,480,000 lekë nga subjekti privat “A” sh.p.k. nuk është e shoqëruar me faturat tatimore të shitjes, në kundërshtim me pikën 2.3.1.a të KVK.

4. “Autorizim prodhuesi” i lëshuar nga vet BOE, sipas të cilit ... *Të butat, veshmbathje ... (të tre lotet) do të jenë prodhime të firmës “E” sh.p.k. dhe “Gj” sh.p.k. sipas specifikimeve*

teknike të DT. Deklarata e origjinës e paraqitur nga BOE, sipas së cilës ... origjina e materialeve të buta .. etj, do të jenë të firmës “E” sh.p.k. dhe “Gj” sh.p.k.

Deklarata për cilësinë e BOE, sipas së cilës ... të gjithë artikujt ... janë të cilësisë së parë dhe këtë e vërtetojmë me Raport analizën e të gjithë lëndëve të para të përdorura..., komprometohet, pasi: OE “Gj” sh.p.k. nuk ka certifikatë ISO 9001-2008 (pika 1), kriteri i vendosur në pikën 2.4. të KVK, kërkon “Autorizim prodhuesi”, nga prodhuesi i lëndës së parë, ndërkohë që BOE nuk është prodhues i lëndës së parë, por është përdorues i saj. Gjithashtu theksojmë se “Raporti i testimit” i lëshuar nga laboratorit ka përcaktuar se ... i përket vetëm kampionit që i është nënshtruar provës. Në këtë situatë mungon lidhja midis kampionit të lëndës së parë që i është nënshtruar “Raportit të testimit” të kryer nga Laboratori, me lëndën e parë që do të përdoret për prodhimin e artikujve. Kampionin e ka marrë dhe paraqitur në laborator, vet BOE.

Nisur nga sa më sipër KVO duhet të s’kualifikonte edhe BOE “E” & ”Gj” sh.p.k. dhe duke qenë që të gjithë operatorët ekonomik nuk plotësonin kriteret, pranimi i një oferte më të lartë ka shkaktuar minimalisht efekt negativ në buxhetin e shtetit për diferencën me operatorin me vlerë më të ulët të skualifikuar, në këtë rast në vlerën 15,241,292 lekë, midis ofertës të OE “A3 ” sh.p.k dhe BOE “E” & ”Gj” sh.p.k. Për këtë kemi ngarkuar me përgjegjësi KVO.

4. Për shkeljet në tenderin me objekt “Blerje automjete speciale për Ministrinë e Mbrojtjes” me fond limit 25,833 mijë lekë. Objekt i tenderit është një makinë borëpastruese dhe një pirun (vinç). Në sistemin elektronik të APP, u konstatua se kanë marrë pjesë OE:

Nr	Operatorët ekonomikë	Njësia e matjes	Ofertat ekonomike		
			Pa TVSh	Me TVSH	
1	A	Lekë	25,100		s’kualifikohet
2	St	”	25,200		”
3	M.B.	”	25,400		”
4	RR	”	25,700		Fitues
5	Si	”	25,800	30,960	s’kualifikuar
6	Al	”	25,833		”

KVO ka skualifikuar OE “A” sh.p.k, “St” sh.p.k. & “MB ” sh.p.k. dhe “Si” kryesisht për mungesa në dokumentacionin ligjor administrativ kualifikues, të cilat pas verifikimit rezultojnë të drejta.

Nga auditimi u konstatua se edhe OE “RR grup” sh.p.k. fitues i tenderit nuk plotëson kriteret e përcaktuara në KVK, pasi tek furnizime të ngjashme me objektin e prokurimit, paraqitur nga OE “RR” sh.p.k. nuk gjenden përputhje me kërkesat e pikës 2.3 “kapaciteti teknik” të KVK të DST. Kështu për punime të ngjashme me objektin e prokurimit janë paraqitur një kokë trajleri me vleftë 23,000 mijë lekë dhe një kamion vinç me vlerë 3,504 mijë lekë, të cilët nuk plotësojnë kriterin e kërkuar.

Në KVK është përcaktuar furnizime të ngjashme me objektin e prokurimit me vlerë 10,333 mijë lekë.

Mungonte në stafin e vet të vërtetuar me listë pagesat për periudhën janar - shtator 2014, një inxhinier mekanik ... fakt që bie në kundërshtim me pikën 2.4.6. të KVK.

OE “RR” sh.p.k. ka paraqitur listë pagesë vetëm për muajin tetor 2014, ndërkohë që është kërkuar që ofertuesi ... duhet të ketë në stafin e tij një inxhinier mekanik ... dhe duhet të

paraqesë diplomën e inxhinierit teknik ... si dhe listë pagesat për periudhën janar – shtator 2014.

Mungon deklaratat origjinale të garancisë (e prodhuesit) për mallrat që ofron, në kundërshtim me pikën 2.4.4. të KVK.

OE “RR” sh.p.k. si dokument origjinal të garancisë ka paraqitur një “Deklaratë garancie” të lëshuar nga vet OE “RR” sh.p.k.

Gjithashtu si autorizime prodhuesi ka paraqitur një fotokopje në anglisht lëshuar nga:

- DT me datë 5.11.2014 për mjetin borëpastruese ..., të noterizuar datë 8.11.2014 me shënimin nga noteri ... *vërtetohet përkthimi i dokumentit bashkëngjitur* (jo nga origjinali. Normalisht noteri shprehet përkthyer nga origjinali).

- GP me datë 5.11.2014 për mjetin pirun ngarkues ..., të noterizuar datë 8.11.2014 me shënimin ... *vërtetohet përkthimi i dokumentit bashkëngjitur* (jo nga origjinali).

Nga verifikimi i dokumentacionit fizik të sjellë nga OE “RR” sh.p.k. konstatohet se autorizimet nuk janë origjinale.

Nuk ka paraqitur një specialist të specializuar nga fabrika prodhuese, i cili do të trajnojë stafin për secilin nga automjetet, në kundërshtim me pikën 2.4.9. të KVK.

OE “RR” sh.p.k. si dokument CV ka paraqitur fotokopje anglisht të lëshuar nga GP me datë 6.11.2014 për një person, i cili kryen disa detyra në kompani, por jo trajnues, me shënimin e noterit ... *vërtetohet përkthimi i dokumentit bashkëngjitur* (jo nga origjinali).

Në fund të dokumentit, firma dhe vula është data 8 nëntor. Konstatohet se dokumenti është lëshuar njëkohësisht datë 8 nëntor në Kinë dhe po në datë 8 nëntor 2014 është noterizuar në Shqipëri.

Ndërsa nga DT me po të njëjtën datë paraqitur CV për një person, i cili kryen disa detyra në kompani, por jo trajnues, me shënimin ... *vërtetohet përkthimi i dokumentit bashkëngjitur* (jo nga origjinali), edhe në këtë rast dokumenti është lëshuar njëkohësisht datë 6 nëntor 8 nëntor në Kinë dhe në datë 8 nëntor 2014 është noterizuar.

Në të dy rastet nuk vërtetohet se janë specialistë për qëllimin e kërkuar dhe në asnjë rast nuk shprehen se marrin përsipër trajnimin e stafit që do të përdorë mjetet. Mungon lidhja midis kërkesës që ka AK për trajnimin e stafit që do të drejtoj pirunin, me CV e paraqitura. Sa më sipër është shoqëruar me një deklaratë nga OE “RR” sh.p.k. sipas së cilës ... *shoqëria jonë (OE “RR” sh.p.k.) merr përsipër trajnimin e stafit i cili do të drejtojë mjetet ...*

Nga verifikimi i dokumentacionit fizik të sjellë nga OE “RR” sh.p.k. konstatohet se autorizimet nuk janë origjinale.

Ka mospërputhje midis afatit të lëvrimit të mallit nga momenti i lidhjes së kontratës, i cili në specifikimet teknike të sjella nga OE “RR” sh.p.k. është përcaktuar 30 ditë, kurse në deklaratimet e bëra nga shoqëritë kineze afati i lëvrimit është përcaktuar 90 ditë, në kundërshtim me shtojcën 10 pjesë e DST të tenderit.

Deklarimet e shoqërive kineze kanë mangësi pasi:

- Nuk janë origjinale,
- Nuk janë të adresuara, për cilin institucion, tender etj.
- Deklarimi i lëshuar nga kompania “DT ...”, nuk ka datë, kurse deklaratat e përkthyer dhe noterizuar ka datë 5.11.2014.

Certifikata e konformitetit e paraqitur nga “DT ...” Kinë, nuk është e rregullt, në kundërshtim me 2.4.8. të KVK, pasi është një deklaratë personale e shoqërisë kineze, fotokopje, sipas së cilës ... *produktet e tyre si borëpastrues ... janë vlerësuar me certifikatë për përputhje me normat standarde të BE.* Në KVK është kërkuar certifikatë konformiteti për automjetet që do

të ofertohen. OE "RR" sh.p.k. ka paraqitur si Certifikatë Konformiteti, një dokument të lëshuar nga Bullgaria, jo origjinal, i cili është noterizuar *vetëm* për përkthimin (jo për origjinalin).

Në paragrafin e fundit të saj është shprehur se ... *kjo certifikatë konformiteti është bazuar vetëm në vlerësimin e dosjes teknike të produkteve ... dhe nuk përfshin një vlerësim të produktit. Ky paragraf komprometon certifikatën e konformitetit.*

Katalogu i paraqitur për mjetin borëpastrues është një faqe në të cilin jepet një përshkrim kryesisht për funksionin e mjetit, por nuk jep asnjë hollësi teknike. Për mjetin pirun janë përkthyer disa specifikime teknike, por me ndryshime dhe tregues të paqartë ndaj kërkesave që ka paraqitur AK.

Nisur nga parregullsitë e evidentuara, KVO duhet të skualifikonte OE "RR" sh.p.k. Parregullsitë e konstatuara ngarkojnë me përgjegjësi KVO. Diferenca në vlerë prej 500,000 lekë, midis ofertës të OE "St" sh.p.k dhe OE "R & R" sh.p.k. përbën efekt negativ në buxhetin e shtetit dhe ngarkon me përgjegjësi KVO.

5. Për shkeljet në tenderin me objekt "*Blerje Fuoristrada & Mikrobusë*" për Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit (DPPSH), loti i parë, me fond limit 169,596 mijë lekë, me fitues OE "HA", me ofertë ekonomike 169,176,000 lekë, kanë skualifikuar OE "Av", me ofertë ekonomike 40,795,628 lekë më të ulët se sa OE i shpallur fitues, i cili nuk ka konkurruar plotësisht për lotin e parë, pasi nuk ka sjellë ofertë ekonomike për 4 automjete tip Fouristradë, pasi ky lot përbëhet nga 40 Mikrobusë dhe 4 Fouristrada.

Nga DPPSH janë bërë llogaritjet e fondeve limit për çdo automjet, ndërsa ndarjet në lote janë bërë nga Drejtoria e Përqendruar e Prokurimeve Publike të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Në këtë blerje është edhe një kërkesë nga institucioni i Shëndetit Publik Tiranë për një Fouristrad me fond limit 1,233,858 lekë. Drejtoria e Përqendruar e Prokurimeve Publike ka bërë vetë këtë ndarje në lote, e konkretisht:

Loti i parë "Blerje Fouristrada & Mikrobusë për DPPSH, me fond limit total prej 141,330,000 lekë për 44 automjete gjithsej;

Loti i dytë "Blerje Mikrobusë 4x4 dhe ambulanca", DPPSH, me sasinë respektivisht 15 Mikrobusë dhe 2 Ambulanca, me vlerë totale fond limit 95,666,667 lekë;

Loti pestë "Blerje Fouristrada" 4x4 për 1 copë me fond limit 1,233,858 lekë.

Nga grupi i auditimit u bë auditimit i vetëm lotit të parë "Blerje Fouristrada & Mikrobusë". Ndarja në lote nuk është konformë VKM nr. 1, datë 10/01/2007, me ndryshimet, Kreu II-Rregullat e përgjithshme të prokurimit, pika 2 "Llogaritja e vlerës së kontratës", germa (dh), ku cilëson shumë qartë se si mund të bëhet ndarja në lote, e konkretisht: "*Kontrata ndahet në lote, kur përbëhet nga mallra..., homogjene ose të ngjashme, dhe kur vlera e kombinuar është e tillë që vetëm një numër i vogël operatorësh ekonomikë do të ishin në gjendje t'i siguronin ato. Kjo mënyrë mund të përdoret veçanërisht për të nxitur pjesëmarrjen e biznesit, të vogël e të mesëm, apo për të ulur kostot administrative të autoritetit kontraktor.....*".

Pra, loti i parë për "Fuoristrada & Mikrobusë" nuk janë mallra homogjen ose të ngjashme si dhe këto mallra nuk i prodhon vetëm një numër i vogël operatorësh ekonomik për ti siguruar, por ka shumë operator që i prodhojnë. Madje mund të ishte bërë lot më vet Fuoristradat dhe më vete Mikrobusë, pasi në lotin e parë ka Fouristrada, që duhej të ishte bashkuar me lotin nr. 5, sepse ka vetëm Fouristrada.

Po kështu loti i parë ka Mikrobusë dhe duhej bashkuar me lotin e dytë që ka blerje 15 copë Mikrobusë, pasi konstatojmë që specifikimet teknike të mikrobusëve të dy loteve janë pothuaj të njëjtë (ndryshojnë vetëm përmasat). Ndërkohë që kombinimi i tyre me automjete që nuk afrohen as me specifikimet teknike të tyre dhe as me përdorimin vë në dyshim dëshirën e mirë për të siguruar mallra cilësor dhe duke i përdorur me efektivitet fondet në dispozicion. Nga ana tjetër konstatohet lehtësisht se të dy tipet e mikrobusëve janë siguruar me çmime të ndryshme dhe me diferencë të madhe nga njëri tjetri, pavarësisht se karakteristikat teknike i kanë të njëjta.

Kjo ndarje e gabuar në lote ka influencuar gjatë hapjes së procedurës së tenderit duke sjellë edhe vështirësi, sepse një konkurrent për lotin e parë ka paraqitur ofertë ekonomike vetëm për 40 Mikrobusë, ndërsa për 4 Fuoristrada nuk ka paraqitur ofertë ekonomike. Mirëpo oferta ekonomike e 40 Mikrobusëve e konkurrentit të skualifikuar (vetëm përse nuk ka sjellë ofertë për 4 Fuoristrada) është shumë më e ulët se atij të shpallur fitues, i cili ka paraqitur ofertat e të dy llojeve të automjeteve.

E parë në një kontekst më të gjerë atë të përdorimit me efektivitet të fondeve theksojmë se një bashkim i tillë mekanik pa vënë në dyshim qëllimin e mirë të KVO ka shkaktuar një impakt negativ në buxhetin e shtetit për vlerën prej 40,795,628 lekë. Në këtë rast gjykojmë se parregullsitë e konstatuara ngarkojnë me përgjegjësi **Njësinë e prokurimit**.

6. Për shkeljet në tenderin me objekt *“Blerje pajisje elektronike dhe telekomunikacioni”* loti tretë - Blerje Projektorë, me fond limit me tvsh 1,150,200 lekë, me vlerë fituesi “B”, prej 762,300 lekë, pasi kanë skualifikuar OE me ofertë ekonomike 92,340 lekë më të ulët se sa OE i shpallur fitues. Në përfundim të auditimit, sipas verifikimit të platformës elektronike kanë paraqitur interesa për të marrë pjesë në këtë lot 6 konkurrent si: “F”; “A1”; “C”; “B”; “J” dhe “Io”. Nga këto 6 konkurrent të interesuar kanë hedhur dokumente në ditën dhe orën e caktuar për zhvillim tenderi 5 konkurrent, ndërsa 1 konkurrent si “A1” nuk i ka hedhur dokumentet. Sipas verifikimit në platformën elektronike, KVO-ja ka skualifikuar 2 operator ekonomik konkurrues e pjesëmarrës në tender, operatorin ekonomik “F”, me ofertë ekonomike në vlerën me tvsh prej 669,960 lekë, me këto argumentimin se nuk përmbush pikën 2.2 “kapacitetit teknik”, furnizimet të ngjashme të realizuara gjatë 3 viteve të fundit financiar, nuk ka paraqitur grafikun e lëvrimit dhe nuk ka paraqitur tabelat sipas autoriteteve kontraktore, për sasi të dhe vlerat e mallrave.

Konkurenti “F” ka bërë ankesë pranë autoritetit kontraktor, por autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje negative, duke dhënë edhe një shpjegim të gabuar me shkresën nr. 1178/1, datë 25/11/2014 se *“në kontratat e ngjashme të paraqitura, rezultojnë se 3 prej tyre janë të lidhura në vitin 2014”*.

Në këtë rast, sipas mendimit të grupit të auditimit, KVO-ja nuk ka vepruar drejt, pasi njësia e prokurimit për furnizimet e mëparshme të ngjashme nuk ka cilësuar për vitet 2011, 2012 dhe 2013, por është cilësuar thjeshtë *“3 vitet e fundit financiar”*, ku me vit financiar nuk kuptojmë vit kalendarik, por kuptojmë vit financiar deri tek periudha e datës së zhvillimit të tenderit. Gabimi i KVO-së është se fillimisht nuk janë cilësuar vitet 2011, 2012 dhe 2013, por është cilësuar thjeshtë 3 vitet e fundit financiar. Theksojmë se nuk ka vepruar me të njëjtat standarde si për lotin e kompjuterëve, që fituesi i tenderit ka pasur edhe kontrata të mëparshme të vitit 2014 dhe nuk ka kryer të njëjtin veprim si me këtë konkurrent.

Ndërsa për pikat e dytë dhe tretë, KVO-ja ka vepruar drejtë, megjithatë duhej të kishte bërë një analizë veprimesh mes fituesit të kualifikuar dhe këtij konkurrenti, pasi edhe vetë fituesi i tenderit “B” nuk i ka plotësuar 100% kërkesat kualifikuese, pasi konstatohet se në pikën nr. 2 të Kriterëve të Përgjithshme, germa (a) është kërkuar dokumenti që vërteton se konkurrenti ka plotësuar detyrimet fiskale, të lëshuar nga Administrata Tatimore, ndërkohë që në shkresën nr. 15100/2, datë 13/10/2014, të administratës tatimore, shpjegohet se ka detyrim (gjoba) në dëme pa tatim në vlerën prej **16,545,000 lekë**, që është edhe në proces apelimi dhe proces gjyqësor. Pra nuk e plotëson këtë kërkesë kualifikuese, sepse sipas legjislacionit të prokurimit publik në fuqi sqaron shumë qartë se kërkon dokument që ka plotësuar detyrimet fiskale. Gjithashtu për të gjitha furnizimet e mëparshme, të ngjashme, nuk paraqitet plotësisht me dokumentacione të rregullta, pasi vërtetimi i paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor Tiranë, nuk ka të cilësuar datën, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara apo praktika dokumentare për furnizimet e KESH-it, rezulton se kontrata është e muajit Janar 2014, në një kohë që dokumentet janë kërkuar vetëm për vitet 2012 e 2013 **(duhej pranuar me të njëjtin standard, pasi për furnizime të tilla është skualifikuar konkurrenti “F”)**. Edhe vërtetimi i paraqitur nga blerësi nuk ka të cilësuar datën, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara, fatura tatimore e blerësit privat “K” është pa vulë të shitësit si dhe pa emër, dhe nënshkrim të blerësit, praktikat dokumentare të ISKSH Tiranë, janë për një projekt shërbimi dhe jo blerje e furnizim mallrash, madje kontratat janë të periudhave para 3 viteve, (datat 01/04/2011 dhe Korrik 2011, kur tenderi është zhvilluar në muajin Nëntor 2014), edhe dy praktikat dokumentare të Rektoratit Tiranë, si kontrata datë 4/2/2014 është jashtë periudhës kohore të kërkuar nga njësia e prokurimit, pra nuk është kërkuar viti 2014 (duhej pranuar me të njëjtin standard, pasi për furnizime të tilla është skualifikuar konkurrenti “F”). Edhe vërtetimi i paraqitur nuk ka të cilësuar datën, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara. Gjithashtu në këto furnizime kemi edhe artikuj jashtë IT, si Televizor, Perde, Mikrofona tavoline, Kamera, Kondicioner, etj., që shkojnë afërsisht rreth 2 milion lekë, vërtetimi i paraqitur nga blerësi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, nuk ka të cilësuar datën, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.

Pra, ky konkurrent i kualifikuar nga KVO-ja, nuk e plotëson vlerën e kërkuar për lotët pjesëmarrëse në tender, i cili ka marrë pjesë në 4 lote (III, IV, V, VI), që kanë vlerën e fondit limit rreth 131 milion lekë dhe kërkohet 30% të furnizimeve të mëparshme të ngjashme, pra rreth 39,3 milion lekë duhet të ketë furnizime të ngjashme. Në këto kushte KVO-ja duhej të kishte zbatuar nenin 53, pikën nr. 4, për devijimet e vogla, duke bërë krahasimet e operatorit ekonomik “F” dhe konkurrentit “B”, pasi edhe fituesi sipas kriterit të miratuar nga Njësia e prokurimit do të shpallej me çmim më të ulët dhe jemi para faktit se të dy konkurrentët nuk plotësojnë 100% kërkesat kualifikuese, porse jemi para faktit se operatori ekonomik “F” ka çmimin më të vogël. Skualifikimi i OE me ofertë ekonomike më të ulët përbën efekt negativ në buxhetin e shtetit *me efekt negativ prej 92,340 lekë*.

7. Për shkeljet në tenderin me objekt *“Blerje pajisje elektronike dhe telekomunikacioni-loti VI”- Blerje kompjuter, desktop, vworkstation, laptop* me fond limit 140,240,040 lekë, kanë skualifikuar OE “F”, me ofertë ekonomike 3,174,077 lekë më të ulët se sa OE i shpallur fitues, “B”. Edhe ky lot ka të njëjtat mangësi si tek loti i cilësuar më lart, loti tretë Blerje Projektorë, pra arsytimi është i njëjtë por në këtë rast skualifikimi i operatorit ekonomik “F” me çmimin më të vogël, ka pasur një efekt negativ në buxhetin e shtetit *në vlerën prej 3,174,077 lekë*.

8. Për shkeljet në tenderin me objekt *“Blerje Certifikatash për Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile”*, me procedurë të hapur, me datë zhvillim tenderi 13/03/2014, me fond limit

14,999,999 lekë, me fitues OE "Ad", në vlerën prej 14,340,600 lekë, kanë skualifikuar OE "AT", me ofertë ekonomike 1,605,706 lekë më të ulët se sa OE i shpallur fitues. Sipas anëtarëve të KVO-së asnjë konkurrent nuk i plotëson kërkesat kualifikuese të miratuar nga Njësia e prokurimit. Konkurrenti i shpallur fitues ka paraqitur ankesë deri tek institucioni i Komisionit të Prokurimit Publik dhe ky institucion i ka kthyer përgjigje që duhet kualifikuar se nuk ka mangësi të mëdha.

Në këtë situatë KVO dhe Njësia e prokurimit duhet të kishte dërguar për ndjekje të mëtejshme, në zbatim të nenit 64/2 "Vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik", pika 2, e LPP, me ndryshimet nr. 64/3 si dhe nenit 53 "Shqyrtimi i ofertave", pika 4, të LPP, me ndryshimet, që cilëson: *"Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë materialisht ose nuk devijojnë nga karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, apo gabime, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj"*.

Për sa më sipër, grupi i auditimit duke parë, që kriteri i vlerësimit të miratuar nga Njësia e Prokurimit, është *çmimi më i ulët* si dhe operatorët ekonomik të paraqitur në konkurrencë nuk i plotësojnë 100% kërkesat kualifikuese, atëherë KVO-ja në këto kushte, tenderin duhej ta kishte anuluar dhe përsëritur nga e para, ose **në të kundërtën të kishte shpallur fitues konkurrentin që është paraqitur me çmim më të ultë**, duke u nisur edhe nga vendimi i marrë nga KPP, i cili nuk ka shpallur fitues ankimesin, por këtë e ka kualifikuar. Skualifikimi i OE me ofertë ekonomike më të ulët përbën efekt negativ në buxhetin e shtetit *me efekt negativ prej 1,605,706 lekë*.

Kualifikimet e kryera janë të papajtueshme me KVK, kërkesat specifike të përcaktuara në DST, pasi cenojnë përcaktimet e parashikuara në nenin 1 "Objekti dhe qëllimi", të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar. Në këto kushte, KVO i OQB, duhet të skualifikonte OE që i ka shpallur fitues dhe në mungesë të një ofertë të vlefshme, në mbështetje të nenit 24/ç të ligjit 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar, në të cilën është përcaktuar se procedura e tenderit **anulohet ... nëse asnjë nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit** dhe zbatim të pikës 1 të Kreu-¹ të VII të VKM nr. 1, datë 10.1.2007 i ndryshuar, ... *autoriteti kontraktor ... fillon një procedurë të re ...*

Efekt negativ në buxhetin e shtetit, për të gjithë tenderët e përshkruar është 77,511,828 lekë gjithsej. Në formulimin *"Efekt negativ në buxhetin e shtetit"* janë përfshirë ato procedura tenderimi, në të cilat OE kanë mangësi në dokumentacion, por njeri prej tyre, ai me ofertë ekonomike më të lartë kualifikohet dhe shpallet fitues, kurse OE me parregullsi të njëjtë, ose të ngjashme, por me ofertë ekonomike më të ulët, është skualifikuar. Fondi limit për tenderët me efekt negativ në buxhet është 518,830 mijë lekë, ose rreth 15 për qind e fondit limit të tenderëve të audituar.

Zj. V.K. është pjesëmarrëse në të gjithë procedurat e tenderimit të përshkruar.

Zj. E. P. është pjesëmarrës në procedurën e tenderit me objekt "Blerje tonerë", "Blerje certifikata".

Zj. A. N. është pjesëmarrës në procedurën e tenderit me objekt "Blerje tonerë", "Blerje uniformash, veshmbathje dhe elementë të tjerë, përbërës të tyre", "Blerje pajisje elektronike" loti III.

Zj. J. Q., D. C. dhe A. H. janë pjesëmarrës në procedurën e tenderit me objekt "Blerje Fuori strada & Mikrobusë".

Z. A. K. është pjesëmarrës në procedurën e tenderit me objekt “Blerje tonerë”, “Blerje uniformash, veshmbathje dhe elementë të tjerë, përbërës të tyre”, “Blerje pajisje elektronike loti III dhe VI.

Z. M. P. është pjesëmarrës në procedurën e tenderit me objekt “Blerje tonerë”, “Blerje Fuoristrada & Mikrobusë”, “Blerje pajisje elektronike” loti III,

Z. A. J. “Blerje uniformash, veshmbathje dhe elementë të tjerë, përbërës të tyre”.

Z. Y. P. është pjesëmarrës në procedurën e tenderit me objekt “Blerje uniformash, veshmbathje dhe elementë të tjerë, përbërës të tyre”, “Blerje pajisje elektronike” loti III, *“Blerje automjete speciale për Ministrinë e Mbrojtjes.*

Z. E.Gj dhe A.Z. janë pjesëmarrës në procedurën e tenderit me objekt “Blerje pajisje elektronike” loti III dhe loti i VI.

Zj. Ea S. është pjesëmarrës në procedurën e tenderit me objekt *“Blerje automjete speciale për Ministrinë e Mbrojtjes”*

2. Z. G. G. me detyrë për përgjegjës i Laboratorit Fiziko-Mekanik dhe Kimik i Tekstilit dhe Lëkurës, për shkak se gjatë auditimit të procedurës së tenderit me objekt “Blerje uniformash, veshmbathje etj”, OE pjesëmarrës në tender, sipas kritereve të kërkuara nga MPB, kanë paraqitur analiza të ndryshme të kryera në “Laboratorin e akredituar”, të Universitetit Politeknik të Tiranës. Për kryerjen e këtyre analizave, sipas rregullores, më parë OE duhet të kenë paguar një tarifë të përcaktuar, për llogari të “Laboratorit akredituar”. U verifikua kryerja e kësaj pagese dhe rezultoi se në të ardhurat e Laboratorit mungojnë 580,000 lekë (vlera koresponduese e 58 analizave) që i takonin vetëm këtij tenderi, e cila përfaqëson shumën e paguar nga OE për analizat e paraqitura në tender e nën këtë arsyetim kjo shumë, përbën dëm ekonomik dhe ngarkon me përgjegjësi z. G. G. me detyrë përgjegjës i Laboratorit Fiziko-Mekanik dhe Kimik i Tekstilit dhe Lëkurës (*vlen të evidentohet fakti se njeri nga OE, ka paraqitur dokument origjinal për shlyerjen e detyrimeve*).

E. Të Tjera,

Nisur nga konstatimet e këtij auditivi në Drejtorinë e Prokurimeve të Përqendruara, fakti që për 31 procedura prokurimi të audituara, në 15 prej tyre me fond limit 518,830 mijë lekë është konstatuar dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në vlerën 85,038 mijë lekë, pra rreth 16% e vlerës së prokuruar, si dhe rëndësisë që duhet ti kushtohet jo vetëm nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme forcimit të kontrollit par dhe ngritjes së kapaciteteve të burimeve njerëzore të cilat do të ndikonin në rritjen e vlerës për çdo para të shpenzuar në fondet publike, ky raport do të dërgohet për dijeni edhe Kryeministrit.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Fatmir Zilja përgjegjës grupi, Ymer Stafa, Nerënxa Llapashtica, më tej materiali u shqyrtua nga Kryeaudituesi, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Zbatimit të Standardeve, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Departamentit.